



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR ARTIN PAMOR
Material ndihmës për mësuesit e artit pamor në arsimin e mesëm të ulët



KLASAT 6-9

TIRANË, 2018

Koordinoi:

Majlinda Hala, IZHA

Përgatitën udhëzuesin:

Silvana Maranaku, shkolla “Dëshmorët e lirisë”, Tiranë

Shpëtim Kërçova, Universiteti i Arteve”, Tiranë

Eni Larushku, shkolla “Skënder Çaçi”, Tiranë

Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës “Art pamor” në arsimin e mesëm të ulët është produkt i konsultimeve dhe i diskutimeve me mësues dhe me specialistë të kësaj lënde në këtë cikël shkollimi.

Prodhim i IZHA-s, 2018

www.izha.edu.al

[Copy right © IZHA](#)

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	Qëllimi i udhëzuesit.....	3
II.	Rëndësia e lëndës – art pamor në AMU.....	3
III.	Zhvillimi i kompetencave kyçe nëpërmjet lëndës art pamor	4
IV.	Integritimit ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së arteve	7
V.	Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së artit pamor	9
	<i>V.1 Shembull i zhvillimit të temave ndërkurrikulare</i>	<i>9</i>
VI.	Metodologjia për zhvillimin e lëndës së artit pamor.....	10
	<i>VI.1 Stili i të nxënit pamor.....</i>	<i>12</i>
	<i>VI.2 Stili i të nxënit dëgjimor.....</i>	<i>12</i>
	<i>VI.3 Stili i të nxënit kinestetik.....</i>	<i>13</i>
	<i>VI.4 Brainstorming (stuhi mendimesh).....</i>	<i>13</i>
	<i>VI.5 Diskutimi.....</i>	<i>14</i>
	<i>VI.6 Eksperimenti</i>	<i>14</i>
	<i>VI.7 Puna në grup.....</i>	<i>14</i>
	<i>VI.8 Kujtesa pamore.....</i>	<i>15</i>
	<i>VI.9 Hulumtimi i orientuar</i>	<i>15</i>
	<i>VI.10 Hulumtimi i lirë.....</i>	<i>15</i>
	<i>VI.11 Organizuesit grafikë</i>	<i>15</i>
	<i>VI.12 Teknika: Diagrami i Venit</i>	<i>16</i>
	<i>VI.14 Teknika: Harta e të pyeturit.....</i>	<i>19</i>
	<i>VI.15 Vlerësimi i veprave të artit dhe Kritika e artit</i>	<i>20</i>
	<i>VI.16 Teknika e projektit kurrikular.....</i>	<i>21</i>
VII.	Planifikimi dhe llojet e tij në lëndën art pamor në AMU	28
	<i>VII.1 Llojet e planifikimeve</i>	<i>28</i>
	<i>VII.2 Planifikimi vjetor i lëndës.....</i>	<i>29</i>
	<i>VII.2.1 Shembull: Planifikimi vjetor, realizuar nga programi mësimor, klasa 8-të.....</i>	<i>30</i>
	<i>VII.2.2 Planifikimi sipas periudhave, përgjatë vitit shkollor</i>	<i>31</i>
	<i>VII.2.3 Planifikime ditore.....</i>	<i>35</i>
	<i>VII.2.4 Planifikimi i dy orëve të njëpasnjëshme</i>	<i>39</i>
VIII.	Vlerësimi i nxënësve.....	46
	<i>VIII.1. Vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë).....</i>	<i>47</i>
	Shembull: Evidencë për vlerësimin e vazhduar për 1 (një) periudhë (shtator-dhjetor)	48
	<i>VIII.2 Vlerësimi me detyrë përmbledhëse</i>	<i>49</i>
	<i>VIII.2.1 Shembull: Detyrë përmbledhëse, klasa 9-të arti pamor.....</i>	<i>51</i>
	<i>VIII.2.2 Shembull II, i detyrës përmbledhëse: Ekspozitë.....</i>	<i>54</i>
	<i>VIII.3 Vlerësimi periodik.....</i>	<i>55</i>
IX.	Kriteret e ndërtimit dhe të vlerësimit të portofolit	57
	<i>IX.1. Krijimi i portofolit.....</i>	<i>58</i>
	<i>IX.2 Karakteristikat e portofolit të të nxënit:.....</i>	<i>58</i>
	<i>IX.3 Vlerësimi i portofolit.....</i>	<i>59</i>
	<i>IX.3.1 Instrument i vlerësimit të portofolit të nxënësit</i>	<i>61</i>
X.	Përshkrimi i notës përfundimtare.....	63

I. Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së re art pamor në AMU, synon t'u vijë në ndihmë mësuesve të arit pamor duke dhënë modele sugjeruese lidhur me planifikimin e kurrikulës në nivel shkolle, me planifikimin e mësimdhënies nga mësuesi dhe me vlerësimin e nxënësve. Gjithashtu, ky udhëzues do të sjellë modele të zhvillimit të *temave ndërkurrikulare* apo të *projekteve* që zhvillohen për plotësimin e portofolit të nxënësve, dokumentim i cili pasqyrohet përmes disa kriterëve të caktuara. Planifikimi ditor do të jetë një prej rubrikave mjaft të rëndësishme të llojeve të planifikimit.

Ky udhëzues iu shërben prindërve për qëllime informimi, si dhe specialistëve të arsimit për të monitoruar ose për të mbështetur shkollat e arsimit të mesëm të ulët.

Udhëzuesi i hartuar i shërben:

- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriterëve të vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Specialistit të arsimit**, për të monitoruar ose për të mbështetur shkollat.

II. Rëndësia e lëndës – art pamor në AMU

Arti pamor është pjesë e rëndësishme e kurrikulës dhe pjesë integrale e jetës sonë të përditshme, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Lënda e artit pamor është pjesë e kurrikulës që nga parashkollori deri në arsimin e mesëm të lartë që përfshijnë 6 shkallët e kurrikulës nga *shkallën e parë* deri në *shkallën e gjashtë*.

Risite në kurrikulën e re të artit pamor janë:

- Ndryshimi i emërimit të programit nga “Edukim figurativ” në “Art pamor”.
- Unifikimi i tematikave dhe kompetencave të njëjta me të gjitha lëndët brenda fushës së arteve.
- Ndërtimi i programeve lëndore bazuar në kompetencat e fushës, të cilat mbështetin dhe zhvillojnë kompetencat kyçe.

- Zhvillimi i veprimtarive krijuese nëpërmjet situatave të të nxënit.

Risite në përmbajtje

Programi i artit pamor, nëpërmjet përmbajtjes të përcaktuar sipas tematikave, ka si qëllim, ndërtimin dhe zbatimin e njohurive bazë të nxënësve për formimin artistik, zhvillimin e aftësive vëzhguese pamore, zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve. Ky program synon aftësimin e nxënësve për të njohur dhe vlerësuar vepra të artit shqiptar dhe atij botëror, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike, përfshirjen në veprimtari artistike, duke manifestuar vlerësim ndaj artit pamor kombëtar si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjedisit ku jeton aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike, zhvillimin e kompetencave të artit pamor për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme artistike. Trashëgimia kulturore kombëtare zë një vend të rëndësishëm në këtë program, jo vetëm si pjesë përbërëse e njohurive të tematikës së tretë por e ndërthurur në mënyrë organike edhe me dy tematikat e para. Në këtë lëndë nxënësit kuptojnë dhe argumentojnë qëndrimet e veta, duke ia paraqitur të tjerëve, edukohen të punojë në grup, ndihen të suksesshëm në artin pamor.

Vendi që zë arti pamor në planin mësimor të AMU-së

FUSHA/LËNDËT	Përgatitore	KLASAT								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Art pamor		1	1	1	1	1	1	1	1	1

III. Zhvillimi i kompetencave kyçe nëpërmjet lëndës art pamor

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. **Kompetenca** përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Organizimi i mësimit në art pamor me bazë kompetencat, përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësit realizojnë kompetencat e lëndës së artit pamor, ata njëkohësisht janë duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh.: kompetenca e artit pamor “Krijimi artistik” përfshin përdorimin e elementeve të artit në një punim artistik për të shprehur dhe komunikuar ide dhe mendime, gjë e cila përkon plotësisht me kompetencat kyçe të “Komunikimit dhe të shprehurit”, “kompetencën e të menduarit.

Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të artit pamor pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënësit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Gjatë ndërtimit të kompetencave të artit pamor: **krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit**, nxënësit ndërtojnë edhe kompetencat kyçe si: zhvillimin e personalitetit artistik nëpërmjet veprimtarive; përpunimin e njohurive pamore në mënyrë të pavarur dhe krijuese; zgjidhjen e problemeve të ndryshme artistike; përzgjedhjen e mjeteve në mënyrë të pavarur për të realizuar krijimin; përdorimin e burimeve të ndryshme të informacioni për të krijuar; pjesëmarrjen në veprimtaritë artistike brenda dhe jashtë klasës; zhvillimin e vetëbesimit dhe besimin te të tjerët gjatë veprimtarive artistike në klasë dhe jashtë saj; bashkëpunimin dhe respektin ndaj të tjerëve; promovimin e vlerave më të mira artistike; përdorimin e mjeteve të ndryshme digjitale për prezantim apo për kërkim informacioni etj..

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së artit pamor mësuesi ndjek këto hapa:

- *Përzgjedh* rezultatin/et e të nxënësit nga kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- *zberthen* në rezultate të nxënësit për kompetencat kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënësit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- *përzgjedh* rezultatin/et e të nxënësit për shkallë për kompetencat e lëndës së artit pamor që synon të arrijë nxënësi;
- *zberthen* në rezultate të nxënësit për kompetencat e lëndës së artit pamor për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënësit për shkallë;
- *përzgjedh* përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënësit të kompetencave të artit pamor në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënësit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;

- *planifikon* mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- *kryen* analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e artit pamor.

Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet zhvillimit të kompetencave të artit pamor dhe përmbajtjes së lëndës nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

- 1) Kompetencat kyç “Komunikimi dhe të shprehurit” dhe “Të menduarit” të cilat zhvillojnë te nxënësit të kuptuarin e mesazheve që u drejtohen, të shprehen në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, të përpunojnë në mënyrë të pavarur, kritike, ndërvepruese dhe krijuese informacionin mund të lidhet mjaft mirë me kompetencat e artit pamor “Krijimi artistik”, “Realizimi i punimit” dhe “Vlerësimi i veprave të artit”.

Për shembull: Kur nxënësit krijojnë ata komunikojnë një mendim dhe e shprehin atë nëpërmjet përdorimit të gjuhës vizuale dhe teknikave të ndryshme artistike. Gjithashtu gjatë krijimit ata zgjidhin probleme të ndryshme artistike dhe zhvillojnë mendimin kritik. Në temën mësimore “Histori me fotografi” nxënësit përzgjedhin vetë imazhet fotografike sipas temës, ose i realizojnë ato. Nëpërmjet përzgjedhjes së fotografive apo realizimit të tyre ata mbajnë edhe qëndrim kritik duke vlerësuar ato që lidhen më shumë me idenë e tyre. Edhe gjatë vlerësimit të punimeve të tyre apo të shokëve ata shprehin qëndrimin e tyre.

- 2) Kompetenca kyç “Të mësuarit për të nxënë”, e cila i krijon nxënësve mundësitë për të përzgjedhur mjetet për të realizuar një krijim artistik dhe e përgatitet për të nxënit gjatë gjithë jetës mund të lidhet më së miri me kompetencat pamore.

Për shembull: Në temën mësimore “Zbukurimi i kutisë së dhuratave nëpërmjet teknikës së stampimit” nxënësit zgjedhin vetë cilin nga llojet e stampimit me relief do të përdorin, Ata përdorin burime të ndryshme për të zgjedhur motivin dhe realizojnë në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

- 3) Kompetenca kyç “Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin”, e cila zhvillon te nxënësi shpirtin sipërmarrës, ndërmarrjen e iniciativave mund të lidhet me kompetencat e artit pamor. Një

ilustrim konkret mund të jetë një temë mësimore që lidhet me ndotjen mjedisore dhe impakti vizual që krijon ajo.

Për shembull: në temën mësimore "Si ta përmirësojmë mjedisin ku jetojmë" nxënësit nxiten të shohin me sy kritik lagjen e tyre për të gjetur gjërat që nuk shkojnë në lidhje me ndërtesat, hapësirat e gjelbërta, mungesën me hapësirat për fëmijë, etj.. Ata ftohen të reflektojnë dhe të shprehin nëpërmjet artit për të dhënë idetë e tyre mbi përmirësimin e këtij mjedisi.

4) Kompetencat kyç "Personale" dhe "Qytetare", të cilat zhvillojnë te nxënësi vetëbesimin, vetëvlerësimin, besimin te të tjerët, bashkëjetesën sociale si qytetarë të përgjegjshëm mund të lidhet shumë mirë me kompetencat e artit pamor. Një ilustrim konkret mund të jetë një veprimtari punë në grup, (qoftë projekt, ekspozitë apo konkurs me dy skuadra).

Për shembull: Në temën mësimore "Ekspozita" nxënësit përfshihen në mënyrë aktive në përzgjedhjen e punimeve, bashkëpunojnë dhe respektojnë njëri-tjetrin. Ky bashkëpunim sjell edhe vetëbesimin dhe krijon besimin te të tjerët kur puna ndahet në mënyrën e duhur dhe sipas aftësive të gjithsecilit. Gjithashtu gjatë punës ata diskutojnë së bashku për probleme të ndryshme artistike si: shpërndarjen e punëve, mënyrën e ekspozimit, mënyrën e realizimit etj..

5) Kompetenca kyç "Digjitale", e cila zhvillon te nxënësi përdorimin efektiv të pajisjeve digjitale për të shkëmbyer, prodhuar, krijuar, prezantuar apo përpunuar informacionin mund të lidhet me kompetencat artit pamor. Nxënësit realizojnë fotografi, apo kërkojnë imazhe ndihmëse për krijimin e tyre, kërkojnë të dhëna për një artist apo një periudhë artistike, bëjnë prezantime të kërkimit të tyre apo të krijimeve, etj.

IV. Integritet ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së arteve

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, dinamika, etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si kërcimin, muzikën, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën, shkencat shoqërore. Kështu që edhe në këtë cikël, mësuesit përmes mëimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë nxënësve të konsolidojnë përvojat që ata kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtëjshëm këtyre përvojave. Diagrami i mëposhtëm paraqet disa lidhje të artit pamor me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.

Disa shembuj të integritit ndërlëndor:

Arti pamor: shkencat e natyrës dhe matematika

- Në temën “Format natyrale dhe gjeometrike” koncepti i artit pamor është “Forma dhe klasifikimi i saj”. Këtë koncept nxënësit e përdorin për të krijuar forma të ndryshme dhe të larmishme në krijimet e tyre. Por përpara se të kalojë në procesin krijues nxënësit duhet të pajisen me njohuritë mbi këtë koncept. Në këtë rast na vijmë në ndihmë njohuritë e shkencave të natyrës të cilat i ndihmojnë nxënësit për të kuptuar shumëllojshmërinë e formave natyrale (të bimëve, të kafshëve, të maleve, të fushave, etj.). Gjithashtu matematika me njohuritë mbi format gjeometrike bazë i ndihmon nxënësit të identifikojnë këto forma gjeometrike në natyrë dhe në objektet e krijuara nga njeriu.

Arti pamor: shkencat e natyrës, shkencat shoqërore dhe mjedisi

- Në temën “Familja ime” konceptet e artit pamor janë “Proporcionet dhe hapësira”. Këto koncepte nxënësit i përdorin për të krijuar një kompozim ku personazhet të vendosen në raportet e duhura në marrëdhënie mes tyre dhe me hapësirën ku ndodhen. Nëpërmjet këtij krijimi nxënësit japin edhe një mesazh mbi rëndësinë e familjes. Përpara se të realizojnë punimin e tyre integrimi i njohurive të shkencave të natyrës (anatomia) mbi proporcionet e trupit të njeriut është mëse i nevojshëm për të pasqyruar në mënyrën e duhur personazhet në krijimin e tyre. Gjithashtu i nevojshëm është edhe integrimi i njohurive të shkencave shoqërore dhe mjedisit, që ka lidhje me marrëdhëniet midis pjesëtarëve të familjes, me detyrat e tyre, me profesionet, me mjedisin e shëndetshëm, etj.. Këto njohuri të shkencave shoqërore dhe të mjedisit do të shërbenin për të dhënë një mesazh të fortë edukativ dhe informues.

Arti pamor: Gjuhët dhe komunikimi

- Gjuhët dhe komunikimi, janë pjesë e një integriti të përhershëm në lëndën e artit pamor. Kur nxënësit vlerësojnë punën e tyre apo të shokut ata komunikojnë nëpërmjet gjuhës, mbrojnë një argument apo e hedhin poshtë atë, shpjegojnë dhe analizojnë. Kërkimi i materialeve të ndryshme mbi artin pamor është pjesë e integritit gjuhësor, jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhë të huaja.

V. Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së artit pamor

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Arti pamor është shumë i pranishëm në veprimtaritë e jetës së përditshme dhe është i lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse ajo, jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këta komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu temat ndërkurrikulare që duhet të zhvillohen janë:

- *Identiteti Kombëtar dhe njohja e kulturave;*
- *Të drejtat e njeriut;*
- *Vendimmarrja morale;*
- *Zhvillimi i qëndrueshëm;*
- *Mjedisi;*
- *Ndërvarësia;*
- *Bashkëjetesa paqësore.*

Për zhvillimin e këtyre temave mësuesi p.sh.: përforcon rëndësinë e *Identitetit Kombëtar*, duke e parë në bashkëpunim edhe me njohuritë që kanë nxënësit nga lëndët e tjera. **Ose** nxënësi kontribuon përmes veprimtarive të artit pamor, duke shpalosur *vlerat e kulturës së vet, por edhe duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera*, si në punimet e veta personale ashtu edhe duke bashkëpunuar në grup.


Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi/sja ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmyjet kompetencave të artit pamor me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave. Nxënësi përdor aftësitë e tij pamore që kanë të bëjnë me simbole, vizatime grafike për të zhvilluar një marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai/ajo mund të shpjegojë fenomenet dhe dukuritë pamore në botën e tij dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore (format dhe ngjyrat).

V.1 Shembull i zhvillimit të temave ndërkurrikulare


Dy skemat e mëposhtme, të sjella si shembull, tregojnë qartë lidhjen e njohurive të artit pamor dhe të muzikës me temat ndërkurrikulare: ***Identiteti Kombëtar dhe Bashkëjetesa paqësore.***

Tema ndërkurrikulare:

Bashkëjetesa paqësore



Tema ndërkurrikulare:
Identiteti kombëtar



VI. Metodologjia e punës me lëndën e artit pamor

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të artit pamor do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet

vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar nëpërmjet rezultateve të të nxënës dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia në artin pamor, synon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet *në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar.*

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete, etj..

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- **Kompetencat kyçe;**
- **ndërtimi i çdo njohurie dhe i çdo aftësie** mbështetur në ato të mëparshmet;
- **veprimtari praktike krijuese** në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- **mjete dhe materiale** konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- **krijimi i qëndrimit pozitiv** ndaj lëndës së artit pamor dhe përdorimi i saj përgjatë gjithë jetës;
- **bashkëveprimi mësues-nxënës** gjatë procesit mësimor, duke qenë plotësues të njëri-tjetrit.

Mësimdhënës të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, të kujtesës, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënës, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënës dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënës,

nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe:

- Ruajnë *përfshirjen aktive*;
- Nxisin *diskutimin e hapur*;
- Nxisin nxënësit të krijojnë dhe *të bëjnë pyetjet e tyre*;
- Ndihmojnë në *shprehjen e mendimeve* të nxënësve;
- Ruajnë *motivimin* e nxënësve për të mësuar;
- Siguron një mjedis ku *respektohen mendimet*;
- Krijon një shtresë për *reflektim* në atë që nxënësit *vlerësojnë*;
- Shërben si nxitje për *ndryshim*;
- Vendos shpresë për *përfshirjen kritike* të nxënësve;
- Ndihmon *mendimin kritik* në nivele të larta e të ndërlikuara.

VI.1 Stili i të nxënit pamor

është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: *foto, harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, dvd (ku kemi dy lloj stilesh: pamore dhe dëgjimore) etj..* Të nxënit përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një objekt, ngjarje, personazh, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore.
- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

Në stilin e të nxënit pamor do të gruponim: *Kujtesën pamore; Organizuesit grafikë (teknikat: Diagramin e Venit, kllasterin, hartën e të pyeturit, etj..*

VI.2 Stili i të nxënit dëgjimor

është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet *bisedave, diskutimeve* ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj.. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- Dëgjimin e shpjegimit të njohurive apo një situatë në kontekstin e temës mësimore,

- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme,
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

Në stilin e të nxënës dëgjimor do të gruponim: *Brainstorming; Diskutimi; Hulumtimi i orientuar.*

VI.3 Stili i të nxënës kinestetik

është kur nxënësi përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke *vepruar, luajtur, eksperimentuar, vizatuar* etj.. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:


- E prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore,
- ndërveprojnë me shokët/et dhe mësuesin,
- ndërveprojnë me mjetet e punës,
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Në stilin e të nxënës kinestetik do të gruponim: *Eksperimenti; Puna në grup; Hulumtimi i lirë dhe i orientuar; Vlerësimi i veprave të artit dhe kritika e artit.*

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësuesin të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësimit.

VI.4 Brainstorming (stuhia mendimesh)

Mësuesit mund të përdorin brainstorming si një strategji (metodë) e të menduarit, për të ndihmuar nxënësit të gjenerojnë pyetje, ide dhe shembuj dhe të zbulojnë një ide apo një temë qendrore (kryesore). Gjatë aplikimit të brainstorming, nxënësit ndajnë idetë që u vinë në mendje dhe i regjistrojnë këto ide pa bërë gjykime rreth tyre. Mësuesi/ja mund të përdorë këtë metodë gjatë prezantimit të temës (gjatë situatës së të nxënës), për të përcaktuar atë që nxënësit dinë dhe duan (ose duhet) të mësojnë dhe për të orientuar zhvillimin e mësimit dhe reflektimin. Brainstorming stimulon të menduarit rrjedhshëm dhe fleksibël dhe gjithashtu mund të përdoret për të aftësuar nxënësit në zgjidhjen e problemeve artistike.



VI.5 Diskutimi

Diskutimi është një strategji bashkëpunimi përmes së cilës nxënësit shqyrtojnë mendimin e tyre, reagojnë ndaj ideve, përpunojnë informacionin dhe artikulojnë mendimet e tyre duke i shkëmbyer me njëri-tjetrin dhe me mësuesit. Diskutimi mund të përdoret për të qartësuar konceptet, idetë dhe informacionin. Theksi vihet në bisedën dhe dëgjimin e njëri-tjetrit. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit mund të krijojnë lidhje midis ideve dhe përvojës dhe të reflektojnë mbi interpretime të ndryshme.

VI.6 Eksperimenti

Eksperimentimi është një metodë thelbësore për artin pamor dhe përdoret shpesh për të bërë lidhjen midis konkretes dhe abstraktes. Eksperimentimi kërkon që nxënësit të hetojnë, testojnë, eksplorojnë, manipulojnë, zgjidhin problemet, marrin vendime dhe organizojnë informacione në mënyrë praktike. Eksperimentimi inkurajon gjithashtu nxënësit që të përdorin aftësitë bashkëpunuese në mënyrë efektive në interpretimin dhe komunikimin e gjetjeve. Eksperimentimi rrit motivimin, mirëkuptimin dhe përfshirjen aktive të nxënësve dhe mund të iniciohet nga mësuesi ose vetë nxënësi.

VI.7 Puna në grup

Teknikat e punës në grup u mundësojnë nxënësve të punojnë si ekip për të arritur një qëllim të përbashkët mësimi. Për shembull, një grup nxënësish mund të punojnë së bashku për të krijuar një vepër arti ose për të realizuar një projekt artistik. Përveç produktit përfundimtar të prodhuar nga grupi, një aspekt i rëndësishëm i procesit të të mësuarit bashkëpunues është që çdo anëtar i grupit të shqyrtojë se si grupi funksiononte dhe të vlerësojë kontributin e tij ose të saj në procesin e punës në grup. Diskutimet, shënimet dhe vetëvlerësimi janë disa mënyra në të cilat nxënësit mund të reflektojnë mbi procesin e punës në grup dhe pjesën e tyre në të.

VI.8 Kujtesa pamore

Kujtesa pamore është një proces që shërben për ta bërë një objekt, një ngjarje ose një situatë të dukshme në imagjinatën e nxënësve duke e ndërtuar nëpërmjet përshkrimit me fjalë ose duke përdorur një imazh. Mësuesit mund të përdorin imazhet, gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies, si një ushtrim për kujtesën dhe si një nxitës i rëndësishëm përpara krijimit të punimit. Mësuesit gjithashtu mund të përdorin një sërë stimulimesh pamore (p.sh., ilustrime, fotografi, riprodhime veprash arti, video, objekte reale, grafika), për të ndihmuar nxënësit në krijimin dhe realizimin e punimeve të tyre artistike nëpërmjet teknikave të ndryshme.

VI.9 Hulumtimi i orientuar

Kjo është një metodë mësimore në të cilën nxënësit përdorin mjetet dhe materialet sipas zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon ndërsa nxënësit po eksplorojnë dhe japin udhëzime sipas nevojës, duke përdorur informacionin e mbledhur nga vlerësimi. Për shembull, mësuesi mund të parashtojë një pyetje, që nxit një mendim më të thelluar ose të prezantojë një fjalor të ri.

VI.10 Hulumtimi i lirë

Ky është një aktivitet kyç i mësimdhënies që iniciohet nga nxënësit, duke përdorur materialet artistike në klasë në mënyrat e zgjedhjes së tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe dëgjon si pjesë të vlerësimit të vazhdueshëm ndërsa nxënësit po eksplorojnë (hulumtojnë) lirisht, dhe nuk e drejton eksplorimin ashtu siç bëjnë gjatë eksplorimit të orientuar.

VI.11 Organizuesit grafikë

Përdorimi i grafikëve si mbështetje është një strategji veçanërisht e fuqishme e mësimdhënies. Grafikët, të konsideruar si një çelës pamor, u mundësojnë nxënësve të kuptojnë marrëdhëniet midis elementeve dhe organizimit të tyre në mënyrë pamore dhe jo vetëm nëpërmjet gjuhës, duke e bërë më të shpejtë përthithjen e njohurive. Grafikët mund të përdoren për të regjistruar, organizuar, krahasuar, analizuar dhe sintetizuar informacionet dhe idetë. Ato mund t'i ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë paraprake me konceptet e reja si dhe konsolidimin e kuptimit të tyre.

Shembuj të përdorimit të grafikëve janë: Harta e pyetjeve (realizimi), harta e mendimeve (kllasteri) (reflektimi), tabela e koncepteve (reflektimi), diagrami i Venit (përdoret gjatë reflektimit), afatet kohore (kryesisht në historinë e artit).

Përdorimi i tabelave grafike është jashtëzakonisht i dobishëm kur kryhet fillimisht si një aktivitet brainstorming i klasës apo grupit. Organizatori grafik ofron një mënyrë për të mbledhur dhe paraqitur në mënyrë vizuale informacion mbi një temë që do ta bëjë atë më të kuptueshëm për studentët.


VI.12 Teknika: Diagrami i Venit

është një teknikë, më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve (elementeve të artit, teknikave artistike, periudhave të historisë së artit, veprave të artit të një periudhe, veprave të artit të periudhave të ndryshme, veprave të artit me të njëjtën tematikë, etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimin, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

Veprimtaria zgjat 10'-20', por është në varësi të temës, moshës dhe kohës së përgjithshme në dispozicion.

Teknika e vizatimit me laps

Teknika e lapsave me ngjyra



Tipare dalluese të teknikës së vizatimit me laps.

Vizatimi realizohet nëpërmjet lapsit të zi të plumbit.

Përdoret për të realizuar vizatime bardhezi.

.....

Të përbashkëta

Janë të dyja teknika vizatimi.

Mjeti kryesor është lapsi.

.....

Tipare dalluese të teknikës së lapsave me ngjyra.

Vizatimi realizohet nëpërmjet lapsave me ngjyra.

Përdoret për të realizuar vizatime me ngjyra.

.....

VI.13 Teknika: Kllasteri


ose grupimi i mendimeve ose “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë.

Hapat për realizimin e kllasterit janë të thjeshta dhe të lehta për t’u mbajtur mend:


- Shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqes ku mund të shkruhet).
- Shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Kur idetë vijnë në mend të kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre.
- Shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për gabimet në shkrim apo në shqiptim.

Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit, në të gjitha lëndët dhe me çdo moshë nxënësish. Ai mund të përdoret për të stimuluar të menduarit, përpara se të studiohet pjesa ose për të bërë përmbledhjen e asaj që është studiuar;


Shembulli: 1



Shembulli: 2



Shembulli 3




VI.14 Teknika: Harta e të pyeturit

Është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit. Harta e të pyeturit mund të përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit. Një hartë e të pyeturit mund të përdoret për të menduar rreth çdo lloj çështjeje ose teme, ose gjatë një mësimi për të gjallëruar diskutimin e nxënësve, për t'i mbajtur ata të interesuar rreth problemit dhe për të përmbledhur informacionin e trajtuar.



VI.15 Vlerësimi i veprave të artit dhe Kritika e artit

janë teknika të përshtatshme për të mësuarit në grup. E gjithë klasa mund të bashkëpunojë si një e vetme, pa përplasje dhe rrëmujë. Për shkak të mënyrës se si komentet e nxënësve lidhen dhe ndërtohen mbi njëri tjetrin, veprimtaritë mbi vlerësimin dhe kritikën e veprave të artit janë veçanërisht të përshtatshme për mësimdhënien si një grup i tërë klasës. Hapat e kritikës së artit janë: përshkrimi, analiza, interpretimi dhe gjykimi. Kjo është një metodë mësimore e bazuar në hulumtime që përmirëson të menduarit kritik dhe aftësitë gjuhësore nëpërmjet diskutimeve të imazheve vizuale



VI.16 Teknika e projektit kurrikular

- Projekti kurrikular është strategji e të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj..
- Projekti kurrikular në lëndën e artit pamor është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit.
- Zbatimi i një projekti në lëndën e artit pamor kërkon më shumë se një orë mësimore.
- Projekti kurrikular **mund** të jetë i shtrirë **përgjatë gjithë vitit shkollor**, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë edhe **vetëm brenda një periudhe**. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai e ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje instrumentin për vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.

Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar.

Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.

- Projekti kurrikular kërkon që mësuesi të:
 - Përcaktojë *qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës* (sepse çdo nxënës duhet të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara);
 - të paraqesë *rezultatet e të nxënësve* që do të arrihen nëpërmjet projektit;
 - të paraqesë hollësisht *çdo fazë të realizimit të projektit*;
 - të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit;
 - të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit;
 - të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.
- Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme.
- Realizimi i një projekti në lëndën e artit pamor kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: *kërkime, grumbullim të dhënash, intervista, puna në grup, puna individuale etj..*
- **Fazat kryesore** që ndiqen për realizimin e një projekti janë:
 - ☞ Përcaktimi i çështjes ose problemit për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
 - ☞ Përcaktimi i detyrave që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
 - ☞ Grumbullimi i materialeve dhe/ose mjeteve të nevojshme.
 - ☞ Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të grumbulluara.
 - ☞ Nxjerrja e përfundimeve dhe përgjithësimeve nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitja e produktit përfundimtar.
 - ☞ Prezantimi i gjetjeve dhe përfundimeve të projektit ose prezantimi i produktit të krijuar.
- Për planifikimin e një projekti mësuesi **ndërton planin e projektit**, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij mësuesi

mund të pasurojë planifikimin edhe me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- **Tema e projektit:** (përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit).
- **Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:** (nëse projekti është ndërlëndore, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- **Klasa/t pjesëmarrëse:** (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
- **Rezultatet e të nxënit:** (përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit).
- **Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:** (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- **Partnerët** (nëse ka, p.sh., nëse projekti mbi *Artin figurativ shqiptar*: (periudha e ndërtimit të socializmit) në lëndën e artit pamor ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë lidhur me zhvillimin në fusha të tjera të arteve dhe më gjerë, duke pasur si mbështetje mësuesit e këtyre lëndëve dhe orientimin e tyre për gjetjen e informacionit; arkivat; interneti; galeri, etj.
- **Veprimtaritë kryesore që do të kryen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës.**
- **Burimet kryesore të informacionit:** (mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit).
- **Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:** (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh. nëse projekti planifikohet në 3 orë atëherë duhet vendosur tematika për të tri orët).
- **Përshkrimi i produktit të projektit** (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- **Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:** (mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënit.

Shembull projekti kurrikular me shtrirje gjithë vjetore, për lëndën e artit pamor për klasën e 9-të:

1. *Tema e projektit* “Lëvizjet artistike të artit modern, përfaqësues dhe vepra”
2. *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore*: Projekti do të zgjasë gjatë tri periudhave të realizuara në 3 orë mësimore në lëndën e artit pamor, të planifikuara 1 orë për çdo periudhë.

3. *Klasa/t pjesëmarrëse*: Klasa e IX-a,b.

4. *Rezultatet e të nxënësve* – Në përfundim të projektit nxënësi:

- ☞ Demonstron njohuritë e marra për grumbullimin e të dhënave mbi artin modern sipas kontekstit historik dhe kulturor të ngjarjeve;
- ☞ lexon dhe kupton të dhënat e grumbulluara mbi lëvizjet artistike të artit modern;
- ☞ interpreton të dhënat dhe konsolidon njohuritë mbi ngjarjet, përfaqësuesit dhe veprat në lëvizjet artistike të artit modern;
- ☞ krijon një album me vepra të artit duke i ndarë sipas lëvizjeve artistike dhe autorëve;
- ☞ përdor terminologjinë e duhur artistike për të përshkruar, analizuar, dhe vlerësuar vepra të ndryshme të artit modern të lëvizjeve dhe të autorëve të ndryshëm;
- ☞ bën lidhje ndërmjet njohurive të gjuhës artistike dhe përdorimit të tyre në veprat e artit të përfaqësuesve të ndryshëm;
- ☞ prezanton para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërshtuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
- ☞ bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht me grupin.

5. *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit*:

- ☒ Grumbullimi i veprave të artit, qëllimi i studimit;
- ☒ grumbullimi i informacionit dhe të dhënave;
- ☒ përpunimi i informacionit dhe të dhënave;
- ☒ paraqitja grafike e të dhënave;
- ☒ interpretimi i të dhënave, klasifikimi i veprave për prezantim;
- ☒ prezantimi i tyre.

6. Burimet kryesore të informacionit:

- ☞ Informacioni i marrë nga interneti (kërkim mbi ngjarje, biografi dhe vepra arti).
- ☞ Informacion i marrë nga libra, albume dhe revista arti.

Baza materiale:

- letra të bardha,
- kartonë,
- lapustila,
- Cd,
- foto,
- Dvd etj..

7. Tematika e orëve të planifikuara:

- Ora 1.** Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- Ora 2.** Përpunimi i materialit të grumbulluar, zhvillimi i të dhënave nga kërkime të ndryshme, ppt etj..
- Ora 3.** Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij. Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

Shembull i vlerësimit të projektit kurrikular. Çdo mësues është i lirë të vendosë vetë kriteret e vlerësimit të projektit sipas tematikës që ka përzgjedhur për të realizuar me nxënësit.

Projekti është hulumtues/kërkimor - (shtrihet gjithë vitin)				
Projekti përmban gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	<i>Niveli 1 - Dobët</i> 0-10 pikë	<i>Niveli 2 - mjaftueshëm</i> 11 - 21 pikë	<i>Niveli 3 – Mirë</i> 22- 32 pikë	<i>Niveli 4 – Shumë mirë</i> 33 -40 pikë
(Faza e parë) 15 pikë <i>Demonstrimi i aftësive kërkimore</i>	0-4 pikë Nxënësit: - rrallëherë: fokusohen te detyra e tyre. - Mbledhin informacione jo të përshtatshme. - Përdorin një burim për të gjetur informacionin.	5-8 pikë Nxënësit: - dalin jashtë temës dhe nuk fokusohen vetëm te detyra e tyre. - Mbledhin informacion dhe përmbledhin ato. - Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	9-12 pikë Nxënësit: - janë të fokusuar te detyra e tyre shumicën e kohës. - Mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. - Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	13-15 pikë Nxënësit: - janë të fokusuar te detyra e tyre. Vetëorientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. - Mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe krijojnë komente intuitive për të zgjidhur probleme. - Përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
(Faza e dytë) 15 pikë Realizimi i kërkimit të gjetur	0 -4 pikë Nxënësit: rrallëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit; - informacioni i gjetur shpeshherë është jo i saktë.	5– 8 pikë Nxënësit: ndonjëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit, por jo në mënyrë të vazhdueshme; - shtjellimi i kërkimit është me gabime.	9 – 12 pikë Nxënësit: zakonisht përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit të përshtatshme dhe efektive; - shtjellimi i kërkimit përmban pak gabime.	13 – 15 pikë Nxënësit: përdorin gjatë gjithë projektit përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit të përshtatshme dhe efektive; - shtjellimi i kërkimit është i saktë dhe i qartë.
(Faza e tretë) 10 pikë Prezantimi në mënyrë efektive i projektit	0-2 pikë - Prezantimi i materialit është i çorganizuar dhe rrëmujë - Është e vështirë të kuptosh cilat	3 -5 pikë - Prezantimi i materialit është i organizuar mirë punën e tyre	6-8 pikë Prezantimi i materialit është organizuar mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi	9-10 pikë - Prezantimi i materialit është organizuar shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi

	informacione shkojnë me njëri -tjetrin. - Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.	- jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. - Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.	leximi dhe të kuptuari. Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.	leximi dhe të kuptuari. - Rezultatet e projektit prezantohen qartë.
--	--	---	---	--

Shembull i vetëvlerësimit ose e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Edhe ky shembull është një model që shërben për të orientuar çdo mësues dhe nxënës rreth vlerësimit. Edhe në këtë rast çdo mësues është i lirë të vendosë kriteret sipas tematikave që përzgjedh të zhvillojë.

Projekt kurrikular kërkimor					
Gjithsej 40 pikë (nëse projekti shtrihet gjithë vitin)					
Kriteret e vlerësimit	Treguesi	ShM	M	Mj	D
(Faza e parë) - 15 pikë Demonstrimi i aftësive kërkimore	- Demonstrim i aftësive kërkimore.				
	- Bashkëpunimi në grup.				
	- Grupi orientohet dhe drejtohet vetë.				
	- Përdorimi i shumëllojshmërisë së informacioneve				
	- Fokusimi te detyra e dhënë				
	- Mbledhja e informacioneve të përshtatshme për detyrën				
(Faza e dytë) - 15 pikë Realizimi i kërkimit të gjetur	- Përdorimi gjatë projektit i aftësive kërkimore të përshtatshme dhe efektive				
	- Kërkimi i selektuar i veprave artistike				
	- Përdorimi i informacionit të gjetur dhe veprave të artit për demonstrim				

(Faza e tretë) - 10 pikë Prezantimi në mënyrë efektive i projektit	- Organizimi i materialit që të krijon lehtësi leximi dhe të kuptuari				
	- Rezultatet e projektit prezantohen qartë				
	- Kontribuon pozitivisht në progresin e grupit				

Shënim: *PROJEKTI* synon të masë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në fund të periudhës dhe të vitit shkollor por edhe formimin e kompetencave kyçe dhe lëndore.

MËSUESI është ai që vendos:

- *Temat e projekteve në bashkëpunim me nxënësit të cilat përzgjidhen për tu punuar nga vetë nxënësit.*
- *Orët e përcaktuara se sa do zhvillohet projekti.*
- *Sigurisht çdo temë projekti lidhet padiskutim kryesisht me njohuritë e programit të atij viti shkollor.*

VII. Planifikimi dhe llojet e tij në lëndën art pamor në AMU

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe të lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Mësuesit përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

VII.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën ose modulën përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë (shtator-dhjetor; janar-mars; prill-qershor)
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të fushës/ lëndës.

VII.2 Planifikimi vjetor i lëndës.

Mësuesi, përveç programit mësimor duhet edhe të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik, ku mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha. Periudhat e planifikuara përmes planifikimit vjetor janë:

- Periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar – mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Shpërndarja e përmbajtjes kryesore së lëndës sipas tri periudhave, bëhet në këtë kolonë ku vendosen përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihet njohuri, projekte, përsëritje, ekspozita, biseda, teste etj., në varësi të specifikave të lëndës.

P.sh.: Planifikimi vjetor kryhet duke u bazuar orët e sugjeruara të kohës së përcaktuar në programin e miratuar, për klasën e 8-të të AMU.

Tematikat	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknika dhe procese	Historia, artí dhe shoqëria	Totali

Orët sipas tematikave	10 orë	15 orë	10 orë	35 orë
------------------------------	--------	--------	--------	--------

Shënim:

Planifikimi vjetor kryhet duke u bazuar në orët e sugjeruara të kohës së përcaktuar në programin e miratuar nga Ministria. Mësuesit kanë të drejtë dhe liri të planifikojnë duke lëvizur deri në 10% nga orët e planifikuara orët e sugjeruara.

Realizimi i tri llojeve të planifikimit kërkon realizimin gjatë procesit të mësimdhënies edhe të disa rubrikave që përmban program mësimor. Ato janë:

- Ndërtimin e *kompetencave kyçe*.
- Ndërtimin e *kompetencave lëndore*.
- Përfshirjen dhe zbatimin e *temave ndërkurrikulare*.
- Përfshirjen dhe zbatimin e *fushave/lëndëve* të tjera.

VII.2.1 Shembull: Planifikimi vjetor, realizuar nga programi mësimor, klasa 8-të

TEMATIKAT	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE PËR REALIZIMIN E KOMPETENCAVE		
	SHTATOR-DHJETOR ORË	JANAR-MARS ORË	PRILL-QERSHOR ORË
1. Gjuha dhe komunikimi artistik (10 orë)	<ul style="list-style-type: none"> - Vija - Forma dy dimensionale - Ngjyrat - Tekstura - Vëllimi - Hapësira - Theksi dhe qendra e interesit. - Proporcionet 		
2. Teknikat dhe proceset (15 orë)	<ul style="list-style-type: none"> - Vizatimi - Piktura 	<ul style="list-style-type: none"> - Stampimi - Fotografia - Grafik dizajni dhe prezantimi - Skulptura - Konstruksioni 	
3. Historia arti dhe shoqëria (10 orë)			Zhvillimi i artit në periudhat historike: <ul style="list-style-type: none"> - Baroke; - Klasike; - Romantike; - Realiste; - Impresioniste. - Arti në Shqipëri në fund

			të shek. XIX dhe fillim të shek. XX - Trashëgimi kulturore - Ekspozita dhe ngjarje kulturore
--	--	--	--

Kujdes! Çdo planifikim bëhet duke përcaktuar javët mësimore për secilën periudhë, sipas udhëzimit të fillimit vitit, që del nga MASR, i cili përcakton mbylljen e çdo periudhe. Pra, kur themi 12 - 13 javë mësimore periudha e parë, ndodh që në një vit tjetër shkollor mund të ndodh që periudha e parë të zgjatet edhe 14 javë. Pra nuk është e përcaktuar. Gjithashtu, orari mësimor, dita kur ju do të zhvilloni mësimin mund të shtojë ose pakësojë javët mësimore.

VII.2.2 Planifikimi sipas periudhave, përgjatë vitit shkollor

Planifikimi i periudhës bëhet nga mësuesi duke u mbështetur në nivelin e klasës dhe nevojat e nxënësve sigurisht bazuar në programin mësimor. Është e rëndësishme që edhe nëse nuk është planifikuar ndonjë *situatë të nxëni* gjatë këtij planifikimi, mësuesi e plotëson atë gjatë *planifikimit ditor*.

Planifikimi i

- **detyrave përmbledhëse dhe projektit kurrikular mund të bëhet 2 orë para përfundimit të periudhës.** Kjo për të lehtësuar nxënësit nga mbingarkesa e testeve apo detyrave përmbledhëse në fund të periudhës.

Shembull: Planifikim i periudhës shtator – dhjetor, klasa 7-të

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit:

- *Krijon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike;*
- *kupton drejt mesazhet, që u adresohet;*
- *shprehet qartë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale; është komunikues efektiv;*

Kompetenca e të menduarit:

- *Merr dhe përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;*

Kompetenca e të nxënit:

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:

-
- *Kupton dhe gjen zgjidhje për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.*

Kompetenca qytetare:

Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike; përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe komunitet;

.....

Kompetenca personale:

.....

- *bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.*

Kompetenca digjitale:

.....

- *njih dhe përdor mjetet audio, video Cd, Dvd, aparat fotografik digjital, kamera, etj.*

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Krijimi artistik:

- *përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike;*
-
-

Realizimi i punimit:

-
- *eksperimenton me mjete dhe teknika për të materializuar idetë e tij/saj;*
- *përdor teknikat artistike,*
-
-

Vlerësimi i veprave të artit:

- *Identifikon,*
-
- *interpretton,*
-

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1.	Gjuha dhe komunikimi artistik	Vija si siluetë dhe formë	Silueta dhe forma e objekteve nëpërmjet vijës Nxënësit vëzhgojnë me vëmendje objekte nga natyra ose të krijuara nga njeriu ku vija ndjek	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; hetimi ; zbulimi;	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të	Teksti i artit pamor ; Ilustrime të imazheve nga natyra; Ilustrime

			formën dhe zbulojnë që nëpërmjet vijës mund të krijojnë objekte me forma të larmishme.	mendimin kritik dhe krijues.	krijuara përgjatë orës mësimore.	veprash arti.
1.		_____	_____			
3.		_____	_____			
4.		_____	_____			
5.		_____	_____			
6.		_____	_____			
7.	Tekstura në pikturë	Shenja të ndryshme për të krijuar teksturën Nxënësit vëzhgojnë dhe diskutojnë sesi artistë të ndryshëm e paraqesin teksturën në punimet e tyre nëpërmjet shenjës që ata përdorin.	Shenja të ndryshme për të krijuar teksturën Nxënësit vëzhgojnë dhe diskutojnë sesi artistë të ndryshëm e paraqesin teksturën në punimet e tyre nëpërmjet shenjës që ata përdorin.	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; hetimi, zbulimi; mendimin kritik dhe krijues.	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të krijuara përgjatë orës mësimore.	Teksti i artistit pamor ; Ilustrime të imazheve nga natyra; Ilustrime veprash arti.
8.		_____	_____			
9.		_____	_____			
10.		_____	_____			

11.	Teknika dhe procese artistike	Detyrë përmbledhëse	Konkurs me dy skuadra Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër.	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; hetimi zbulimi; mendimin kritik dhe krijues.	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të krijuara përgjatë tremujorit. vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësve.	Teksti i artist pamor ; Ilustrime të imazheve nga natyra; Ilustrime veprash arti.
12.		Diskutimi dhe vlerësimi i portofolit	-----	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse.	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të krijuara përgjatë tremujorit nëpërmjet elementeve të portofolit.	
13.			_____			

VII.2.3 Planifikime ditore

Shembull: Planifikime ditore, nga klasa 7 dhe 9 -të

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik		Situata e të nxënësve: Forma të ndryshme në natyrë shfaqen në lëvizje të vazhdueshme, si retë, uji, forma e zjarrit etj..	
Tema mësimore: Forma në lëvizje			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:		Fjalët kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar format natyrore në lëvizje; - reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon; - zbulon format në lëvizje në vepra të ndryshme art. - përdor qëllimisht format në lëvizje në krijim për një qëllim të caktuar; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të formave natyrore dhe gjeometrike në krijim. 		<ul style="list-style-type: none"> - Forma dy dimensionale, - forma në lëvizje, - forma në erë. 	
Burimet/mjetet/materialet:		Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:	
<ul style="list-style-type: none"> - Teksti i nxënësve; - fotografi dhe ilustrime veprash arti; - mjete pune. 		<ul style="list-style-type: none"> - Lidhje me fushat kurrikulare: - Shkencat e natyrës - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia - Lidhja me temat ndërkurrikulare: - Mjedisi 	
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve			
<p>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta) - Teknika brainstorming</p> <p>Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situatë ndërvepruese, interaktive dhe përmes një bashkëbisedimi. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të diskutojnë dhe të sjellin shembuj të formave në natyrë që janë në lëvizje si p. sh., format e reve, forma e tymit, format e lumenjve, forma e ujëvarës, forma e flakës, forma e tekstileve. Mësuesi/ja drejton pyetje të tilla: Si mund ta përcaktojmë formën e tyre? A janë këto forma të paqëndrueshme? Si mund t'i paraqesim këto forma në punimet tona?</p>			
<p>Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja- (30 minuta) – Teknika: Kujtesa pamore, eksperimenti.</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se në natyrë ka forma që ndryshojnë vazhdimisht dhe tregojnë lëvizje, të tilla si retë, zjarri, tymi, etj. Por ka edhe forma të tilla të cilat ndryshojnë si rrjedhojë e erës apo dukurive natyrore. Objekte të tilla si tekstilet, bimët, pemët etj., nuk e ndryshojnë strukturën e tyre pasi ato kthehen në gjendjen e tyre fillestare. Këto forma që ndryshojnë tregojnë lëvizje ashtu siç paraqiten edhe në veprat e artistëve.</p>			

Nxënësit nxiten të krijojnë duke përdorur forma në lëvizje në punët e tyre (retë, valët e detit, pemët ose veshjet në erë)

Hapi i tretë: Reflektimi – (10 minuta)- *Teknika: Diskutimi dhe harta e mendimeve (kllasteri).*

Pasi mbarojnë punën, nxënësit flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata diskutojnë që nëpërmjet përdorimit të formave në lëvizje ata mund të krijojnë punime të larmishme.

Vlerësimi i nxënësit/es

Ky vlerësim do të fokusohet:

N2 - në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;

N3 - në mënyrën e realizimit të detyrës;

N4 - në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe të shokëve/shoqeve.

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3-të	Klasa: VII
<p>Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: Trashëgimia kulturore.</p>		<p>Situata e të nxënit: Të zbulojmë dhe kujdesemi për trashëgiminë kulturore.</p> <p>Nëpërmjet fotografive të ndryshme të objekteve të trashëgimisë kulturore si kështjella, parqe arkeologjike, objekte të vjetra me vlerë, veshjet etj., mësuesi/ja i nxit nxënësit të diskutojnë.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgon objekte të trashëgimisë kulturore; - reflekton mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore; - zbulon rolin që luan njohja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore për shoqërinë njerëzore; - identifikon dhe mbledh të dhëna mbi objekte të trashëgimisë kulturore; - shpreh mendimin e vet rreth objekteve të trashëgimisë kulturore. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimi kulturore, - trashëgimi materiale, - trashëgimi shpirtërore, - UNESCO, - trashëgimi botërore. 	
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teksti i nxënësit; - imazhe me objekte të trashëgimisë kulturore; 		<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p>Lidhje me fushat kurrikulare:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia - Teknologjia - Shkencat shoqërore 	

	Lidhja me temat ndërkurrikulare: - Njohja e kulturave
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve- (5 minuta) – Teknika: Kujtesa pamore dhe diskutimi Nëpërmjet fotografive të ndryshme të objekteve të trashëgimisë kulturore si kështjella, parqe arkeologjike, objekte të vjetra me vlerë, veshjet etj, mësuesi/ja i nxit nxënësit të diskutojnë.	
Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja – (30 minuta) – Teknika: Harta e të pyeturit Mësuesi/ja ngre pyetjet se: - Çfarë është trashëgimia kulturore? - Cili është roli që luan njohja dhe ruajtja e saj për shoqërinë njerëzore. - Në sa kategori ndahet Trashëgimia? - Çfarë është UNESCO? - A bëjmë pjesë ne në këtë organizatë? - Mësuesi ngre pyetjet dhe i shpjegon duke përfshirë edhe nxënësit në këtë bisedë. Hapi i tretë: Reflektimi – (10 Minuta) – Teknika: Diskutimi dhe harta e mendimeve (kllasteri). Në një organizues grafik trashëgimia ndahet në dy kategori, në atë materiale dhe shpirtërore. Nxënësit/et sjellin shembuj të njohur për secilën sipas shpjegimeve të mësuesit/es. Në tabelën e UNESCO'S renditen pjesa e trashëgimisë sonë kulturore si Butrinti, Gjirokastra dhe Berati janë të përfshira në listën e trashëgimisë botërore të mbrojtura nga kjo organizatë. Ata diskutojnë se këto objekte janë pjesë nga e kaluara dhe na tregojnë mënyrën e jetesës së brezave të ndryshëm dhe kuptojnë që këto janë një trashëgimi e çmuar kulturore.	
Vlerësimi i nxënësit Ky vlerësim do të fokusohet: N2 - Në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; N3 - në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor; N4 - në realizimin e detyrës duke u mbështetur në identifikimin dhe dokumentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.	
Dosja me punime personale: Identifikon objekte të trashëgimisë kulturore (në familje, në lagje, etj.), mbledh të dhëna për dokumentimin e saj.	

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik		Situata e të nxënësve: Lojë formash	
Tema mësimore: Format pozitive dhe negative			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</p> <p><i>Nxënësi/ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgon dhe reflekton mbi imazhe për të kuptuar rolin e formave pozitive dhe negative në kompozim; - zbulon marrëdhënien figurë/sfond dhe rëndësinë e saj në kompozim; - përdor mundësitë shprehëse të formave pozitive dhe negative në krijim; - shpreh mendimin e tij/saj mbi marrëdhënien midis formave pozitive dhe negative në krijim. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forma pozitive; - forma negative; - marrëdhënia figurë-sfond.
<p>Burimet/mjetet/materialet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teksti i nxënësit; - imazhe fotografike, imazhe të veprave të artit; - materiale pune. 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat e natyrës; - gjuhët dhe komunikimi: letërsia. <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjedisi.
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p><i>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve -(5 minuta) – Teknika: Hulumtimi pamore dhe diskutimi.</i></p> <p>Nxënësit vëzhgojnë një imazh dhe përpiqen të shquajnë objektin dhe sfondin. Imazhet e dykuptimta nxisin hulumtimin pamor të nxënësve për të zbuluar format pozitive dhe negative. Kjo lojë figurash ose iluzioni optik i paraprin njohurive të reja mbi format pozitive dhe negative në një vepër arti.</p>	
<p><i>Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja (30 minuta) – Teknika: Hulumtimi dhe eksperimenti.</i></p> <p>Nëpërmjet veprave të artit ata/ato zbulojnë që marrëdhënie të ndryshme që krijojnë figura dhe sfondi. Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit për t'u shprehur në mënyrë krijuese nëpërmjet formave pozitive dhe negative. Në këtë mënyrë nxënësit zbulojnë mundësitë shprehëse të formave pozitive dhe negative dhe marrëdhënien që krijojnë mes tyre</p> <p><i>Hapi i tretë: Reflektimi – (10 Minuta) – Teknika: Diskutimi.</i></p> <p>Nxënësit diskutojnë së bashku për mënyrën e realizimit dhe marrëdhënien që krijuan midis formave pozitive dhe negative në krijimin e tyre.</p>	
<p><i>Vlerësimi i nxënësit</i></p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p>	

N2 - Në diskutimet që nxënësit/et bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
 N3- në mënyrën e realizimit të detyrës;
 N4 - në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.

VII.2.4 Planifikimi i dy orëve të njëpasnjëshme

Plani mësimor i periudhës “Tri lëndë në gjashtë orë” është një nismë ku mësuesit mund të grupojnë dy tema që vijnë njëra mbas tjetrës ose dy tema që lidhen me njëra- tjetrën, (p.sh., grupohen temat e gjuhës artistike bashkë, temat e teknikave dhe ato të historisë bashkë; ose bashkohen temat e gjuhës artistike me teknikat artistike apo temat e teknikave me ato të historisë (nëse mund të krijohen lidhje të natyrshme me njëra tjetrën, në të kundërt ato grupohen njëra pas tjetrës).

Shembull: Planifikim i periudhës prill-qershor, organizimi i mësimit me dy orë të njëpasnjëshme.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:

-
-
-

Kompetenca e të menduarit:

-
-

Kompetenca e të nxënit:

-

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:

-

Kompetenca qytetare:

-

Kompetenca personale:

-

Kompetenca digjitale:

-

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Krijimi artistik:

-
-

Realizimi i punimit:

Vlerësimi i veprave të artit:

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1	Teknika dhe procese artistike	(I) Relievi dekorativ në vazo	Vazot dekorative Nxënësit diskutojnë për mënyrat e ndryshme të dekorimit të vazove, nëpërmjet imazheve që shohin dhe nga eksperiencia e tyre.	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; Hetimi Zbulimi; Mendimin kritik dhe krijues.	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të krijuara përgjatë orës mësimore.	Teksti i artit pamor; Ilustrime të imazheve; Ilustrime veprash arti.
2		(II)	_____	_____	_____	_____
3	Historia, arti dhe shoqëria	(I) Arti në parahistori	Zbulojmë artin në parahistori Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit nxiten të diskutojnë mbi njohuritë e tyre që kanë marrë në lëndën e historisë për artin në parahistori.	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; Hetimi; Zbulimi.		Teksti i artit pamor; Ilustrime të imazheve; Ilustrime veprash arti.
4		(II)	_____			
5		(I)	_____			
		(II)	_____			

6		_____				
7		(I) _____	_____			
8		(II) Projekt:	_____	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; Hetimi ; Zbulimi; Mendimin kritik dhe krijues.	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të krijuara përgjatë zhvillimit të projektit; Vlerësimi i punës në grup; Vlerësim mes nxënësve	Slide/materiale të krijuara nga nxënësit; Materiale nga interneti dhe nga burime të ndryshme etj..
9		(I) Diskutimi dhe vlerësimi i portofolit	_____	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse.	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive, qëndrimeve të krijuara përgjatë tremujorit nëpërmjet elementeve të portofolit.	
10		(II) Detyra përmbledhëse: Ekspozita e fundvitit.	Krijimet tona në ekspozitë Mësuesi/ja i orienton nxënësit në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është	Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse; hetimi	Demonstrim i rezultateve të arritura të njohurive, aftësive,	Krijimet e nxënësve dhe mjetet ndihmëse për organizimin e ekspozitës.

			çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë. Ata diskutojnë për të zgjedhur titullin e ekspozitës së tyre.	zbulimi; mendimin kritik dhe krijues;	qëndrimeve të krijuara përgjatë tremujorit; Vlerësimi i punës në grup; Vlerësim mes nxënësve.	
11		(I)	_____			

Planifikimi ditor, mësuesi do të hartojë planin ditor *me të njëjtin format që ka punuar deri tani* dhe në varësi të temave mësimore që ka për të zhvilluar. Nëse dy temat kanë njohuri dhe rezultate të të nxënësve të ndryshme, do të punohet me formatin e ndarë si në shembujt e mësipërm. Nëse dy temat lidhen logjikisht me njëra-tjetrën, atëherë **këto dy orë**, mësuesi mund t'i planifikojë në dy mënyra. Në *shembullin e parë* kemi bashkuar dy tema që kanë lidhje logjike me njëra tjetrën, “Ngjyrat” nga tematika “Gjuha dhe komunikimi artistik” dhe “Teknika e monotipit” nga tematika “Teknika dhe procese artistike”. Njohuritë e ngjyrës mund të eksperimentohen mjaft mirë në një detyrë të realizuar me teknikën e monotipit, por meqë në të dyja temat kemi rezultate të të nxënësve specifike i vendosim ato për të dyja orët duke gjetur pikat e përbashkëta siç mund të jetë “Krijon me teknikën e monotipit duke përdorur njohuritë mbi ngjyrën”. Në *shembullin e dytë* kemi bashkuar dy orë që i përkasin të njëjtës temë dhe njohuri dhe ato mund të planifikohen si **një e tërë**. Në orën e parë nxënësit marrin njohuritë mbi teknikën e modelimit me letër dhe realizojnë një maskë me këtë detyrë. Në orën e dytë ata vazhdojnë me realizimin e detyrës dhe përfundimin e saj. Në këtë rast rezultatet e të nxënësve do të jenë për të dyja temat.

Plane ditore, Shembulli i parë

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 3	Klasa: VI
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik; Teknika dhe procese artistike		Situata e të nxënësve: Drita dhe ngjyrat	
Tema mësimore: Ngjyra dhe Teknika e monotipit		Nxënësit identifikojnë ngjyrat e ylberit dhe dritën si burimi i ngjyrave. Ata njohin ngjyrat e para dhe identifikojnë nëpërmjet përzierjes ngjyrat e dyta.	

	<p>Situata e të nxënësve: teknikat e stampimit</p> <p>Nxënësist nxiten të flasin mbi karakteristikat e teknikave të stampimit që ata njohin dhe kanë përdorur.</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temave mësimore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zbulon se ngjyrat krijohen nga drita; - Përdor qëllimisht ngjyrat dhe përzierjen e tyre në mënyrë shprehëse, nëpërmjet teknikës së monotipit; - Shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të ngjyrave dhe të teknikës së monotipit; 	<p>Fjalët kyçe:</p> <p>Ngjyra; rrethi i ngjyrave; ngjyrat e para; ngjyrat e dyta; ngjyrat e treta; ngjyrat e ngrohta; ngjyrat e ftohta.</p> <p>Fjalët kyçe:</p> <p>teknika stampimi; monotip.</p>
<p>Burimet/mjetet/materialialet:</p> <p>Teksti i nxënësist;</p> <p>Fotografi që ilustrojnë njohuritë mbi ngjyrën;</p> <p>Skema e rrethit të ngjyrave;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete pune 	<p>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.</p> <p><i>Lidhje me fushat kurrikulare:</i> Shkencat e natyrës, gjuhët dhe komunikimi: Letërsi, teknologjia.</p> <p><i>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</i> Mjedisi</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>45'</p> <p>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Nxënësist identifikojnë ngjyrat në mjedisin përreth, ngjyrat e ylberit dhe dritën si burim i tyre. Pyetje të tilla si: “A është drita e bardhë? Çfarë ndodh kur drita kalon nëpërmjet prizmit? Ku e keni parë tjetër këtë fenomen? Sa ngjyra janë në spektër?”, nxisin nxënësist në diskutim.</p> <p>Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shfaq rrethin e Itenit dhe fton nxënësist të identifikojnë ngjyrat e para dhe të realizojnë ngjyrat e dyta nëpërmjet përzierjes. Nëpërmjet përzierjes së ngjyrave nxënësist zbulojnë ngjyrat e treta.</p> <p>Ata identifikojnë ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta edhe në lidhje me fenomenet dhe ndjesitë që i shoqërojnë. Nxënësist eksperimentojnë me përzierjet e ndryshme të ngjyrave.</p> <p>Hapi i tretë: Reflektimi</p> <p>Nxënësist diskutojnë mbi njohuritë që morën mbi ngjyrat dhe përdorimin praktik të tyre.</p> <p>45'</p> <p>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p>	

Nxënësit nxiten të flasnin mbi karakteristikat e teknikave të stampimit që ata njohin dhe kanë përdorur . Pyetje të tilla si: “Cilat janë teknikat dhe mjetet e stampimit me të cilat ju keni punuar edhe më parë? A ju ka pëlqyer teknika e stampimit? A është një teknikë e shpejtë?, nxësin nxënësit në diskutim.

Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja shpjegon dhe demonstroi radhën e punës së teknikës së monotipit. Me teknikën e monotipit mund të përftohet vetëm një imazh.. Me tubetet e ngjyrave nxënësit krijojnë figurën e dëshiruar duke vizatuar dhe pikturuar në mënyrë pastoze. Mbi të vendosin me kujdes fletën e vizatimit dhe e përshkruajnë sipërfaqen me rulin ose me një lugë, që letra të ngopet me ngjyrën.

Hapi i tretë: Reflektimi

Pasi mbarojnë punën, nxënësit diskutojnë për mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata diskutojnë për karakteristikat e kësaj teknike dhe rëndësinë e kombinimit të ngjyrave.

Vlerësimi i nxënësit

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit do të fokusohet:

- Në diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re,
- në vlerësimin e punës së secilit nxënës,
- në analizën vlerësuese që nxënësit ju bëjnë punës së tyre dhe të shokëve.

Plane ditore, Shembulli i dytë

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: VIII
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike</p> <p>Tema mësimore: Skulptura. Modelimi me letër i maskës</p> <p>Tema mësimore: Modelimi i maskës</p>		<p>Situata e të nxënit: Modelimi dhe karakteristikat e materialeve për modelim</p> <p>Nxënësit diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj me plastelinë e me materiale që ata njohin.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</p> <p><i>Nxënësi/ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit me letër; - përdor me kompetencë materialin e letrës për modelim; - krijon me teknikën e modelimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore; - shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë 		<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Skulptura; - modelimi me letër; - maska. 	

<i>shprehëse të teknikës së modelimit me letër.</i>	
Burimet/mjetet/materialet: <ul style="list-style-type: none"> - Teksti i nxënësit; - ilustrime të veprave në skulpturë të realizuara nëpërmjet teknikës së modelimit me letër; - mjete të tilla, si: letër, vinovil, plastelinë. 	Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare. Lidhje me fushat kurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - teknologjia. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Njohja e kulturave.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve	
<p>45'</p> <p>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Nxënësit diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj me plastelinë dhe me materiale që ata njohin.</p> <p>Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Mësuesi/ja shpjegon se një formë tjetër mjaft interesante e modelimit dhe mjaft e thjeshtë në përdorim është modelimi i letrës së lagur. Ai/ajo shpjegon se materiali për modelim realizohet duke përzier copa letrash të lagura me ngjites, shpjegon mënyrat e përdorimit dhe mundësitë shprehëse. Teknika është e thjeshtë në përdorim dhe objekti i krijuar me këtë teknikë kur thahet, mund edhe të pikturohet.</p> <p>Në orën e parë nxënësit realizojnë maskën e modeluar me letër. Për këtë ata, ose krijojnë një model me plastelinë, ose përdorin një maskë të gatshme.</p> <p>Hapi i tretë: Reflektimi</p> <p>Pasi mbarojnë punën, nxënësit shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të maskës. Maska lihet të thahet për të qenë gati orën e dytë.</p> <p>45'</p> <p>Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Në orën e dytë të kësaj teme nxënësit diskutojnë që t'u japin karakteristika të veçanta këtyre maskave nëpërmjet ngjyrave duke parë edhe shembuj të ndryshëm.</p> <p>Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Nxënësit i japin karakteristika tipareve të maskave që kanë realizuar një orë më parë. Këtë e bëjnë me ndihmën ngjyrave por edhe të materialeve të tjera ndihmëse (letra me ngjyra etj.).</p> <p>Hapi i tretë: Reflektimi</p> <p>Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të maskës dhe për karakteristikat e tyre.</p>	
<p>Vlerësimi i nxënësit</p> <p>Ky vlerësim do të fokusohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; 	

- në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
- në mënyrën e realizimit të detyrës;
- në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.

VIII. Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilët përcaktohen si të domosdoshëm për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësve dhe mësimdhënies.

Vlerësimi i nxënësve kryhet nëpërmjet:

- ✎ Vlerësimin të vazhduar (vlerësimi për të nxënësve) (40%);
- ✎ vlerësimin me test/detyrë përmbljedhëse (vlerësimi i të nxënësve) (40%);
- ✎ vlerësimin të portofolit lëndor të nxënësve (20%).

Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënësve, mësuesi **mban shënime në evidencë për çdo nxënës**. Shënimet në evidencë mund të mbahen me **notë**, të shoqëruara me nivelin e arritjes dhe konceptin e temës mësimore (p.sh.: N3: *teknika e akuarelit*) dhe **simbole** të shoqëruara me komentimin përkatës (p.sh.: +; √ : *aktivizim i rregullt*; ose *bashkëpunim*; *krijim në grup*; *respektimi i mendimit të shokut/qes*).

- Për lehtësimin e punës së tij mësuesit i sugjerohet të shkruajë në fund të evidencës **një legjendë** e cila shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura.
- Komentet i referohen **niveleve të arritjes së kompetencave lëndore** bazuar në dokumentin përkatës të “*Niveleve të arritjes*” shkalla IV klasa -9.
- Mësuesi është i lirë të përshtatë **formatin e evidencës**, në varësi të specifikave të lëndës, ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj. Për të realizuar vlerësimin e vazhduar mësuesi i artit pamor gjatë orës mësimore përdor fjalë e shprehje inkurajuese.

Shënim: Vlerësimi i vazhduar mbahet përgjatë periudhës dhe në evidencë vendoset ,

NIVELI I ARRITJES së nxënësve (N 2 ose N 3 ose N 4) dhe njohuria/koncepti për atë orë që nxënësi është kontrolluar.

VIII.1. Vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)

Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet ***vlerësim formues*** dhe është vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënit të nxënësve gjatë procesit të të nxënit. Ky lloj vlerësimi mundëson që mësuesi të identifikojë pikat e forta të nxënësve, problemet dhe vështirësitë që ata kanë dhe të japë reagime të menjëhershme, të cilat i ndihmojnë nxënësit të mësojnë më mirë. Gjithashtu, vlerësimi për të nxënë ndihmon mësuesin të planifikojë punën për të zhvilluar mësimin në mënyrë më efektive. ***Shpesh ky vlerësim është informal*** dhe nxënësit mund të mbajnë edhe vetë shënime mbi progresin e tyre. Një shembull është një kuiz i shpejtë për të parë nëse nxënësit i kujtojnë pikat e rëndësishme të mësimin.

Ndryshimi kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësit gjatë zbatimit të kurrikulës së re është vlerësimi për të nxënë (vlerësimi i vazhduar). ***Fokusi kryesor i vlerësimit për të nxënë (vlerësimit të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënit e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar.*** Pra, vlerësimi për të nxënë nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë te nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t'i përmirësojë ato. Në këto kushte, mësuesi duhet të fokusohet te procesi i të nxënit dhe jo te vendosja e notës.

Si dokumentohet vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)?

- Fletorja personale dhe evidenca nënkuptojnë ***të njëjtin dokument***. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënë).
- Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë) ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes.
- Fletoren personale (evidencën) mësuesi ***e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të***, por duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar.
- Mësuesi është i lirë t'i mbajë shënimet në fletoren e tij personale (evidencë) duke vendosur ***simbolet, që ai gjykon si të përshtatshme***, të shoqëruara me komente shumë sintetike, të cilat iu referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Komentit përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (***p.sh., N₃ ose N₄***), si dhe ***konceptin/konceptet përkatëse*** për të cilin është vëzhguar nxënësi.
- Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjet në

aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrateshtëpisë apo të klasës etj., **vlerësohen me simbole**. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënësve, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.

- Nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset **vetëm** në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim etj.
- Nota e vlerësimit të vazhduar që vendoset në regjistër në faqen “Vlerësimi periodik” duhet të jetë **rezultante progresive (ose regresive) e vlerësimeve që mësuesi ka mbajtur** në fletoren e tij personale.
- Fletorja personale (evidenca) **është objekt monitorimi, por nuk** duhet dorëzuar në përfundim të periudhës.
- Mësuesi **mban përgjegjësi për fletoren personale** dhe duhet të argumentojë notën e vlerësimit të vazhduar të vendosur në regjistër.
- Mësuesi duhet **të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor** fletoren personale (evidencën), teste/detyra të ndërmjetme, punët me shkrim, etj. Këto do t’i shërbejnë për të argumentuar notën e vlerësimit të vazhduar.
- Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, ato janë e njëjta gjë.
- Gjatë periudhës, mësuesi i lëndës ka përgjegjësi për të informuar nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e tij për progres.

Shembull: Evidencë për vlerësimin e vazhduar për 1 (një) periudhë (shtator-dhjetor)

Shembull: *Arti pamor (klasa VII), Periudha: shtator – dhjetor*

<i>Nr.</i>	<i>Nxënësi / Data</i>	<i>30.09</i>	<i>14.10</i>	<i>31.10</i>	<i>9.11</i>	<i>9.12</i>	<i>Komentet janë: Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës</i>
<i>1</i>	<i>Megi Dilo</i>	<i>+-</i>					<i>N3. Cilësitë e ngjyrës</i>
			<i>✓</i>				<i>N3. Tekstura në pikturë dhe në stampim</i>
				<i>+</i>			<i>N4. Vëllimi dhe burimi i dritës</i>
					<i>+</i>		<i>N4. Perspektiva lineare qendrore</i>
						<i>10</i>	<i>N4. Konkurs</i>

Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; -- (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbledhëse (NVv).

Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra **NVv është 9**. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.

- Evidenca (fletorja e shënimeve) menaxhohet nga vetë mësuesit. Mësuesi është i lirë të ndryshojë formatin e evidencës duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë dhe të përcaktojë vet se si do të mbajë shënimet për ecurinë e nxënësit.

VIII.2 Vlerësimi me detyrë përmbledhëse

Vlerësimi i të nxënët ndryshe quhet vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi.

Si dhe kur realizohet detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet **vlerësimi me test ose me detyrë përmbledhëse**, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë nëse do të zhvillojë test apo detyrë përmbledhëse sipas specifikave të lëndës.
- Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënët dhe mësuesi është **i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë**.
- Testi/detyra përmbledhëse është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve ose detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Testi/detyra përmbledhëse **jo domosdoshmërisht** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
- Në momentin kur mësuesi **vlerëson testet/detyrat përmbledhëse, i vendos** notat në regjistër.
- Mësuesi duhet **të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor** testet ose detyrat përmbledhëse.

Vlerësimi me detyrë përmbledhëse është një vlerësim që për lëndën e artit pamor duhet të zhvillohet më shumë nëpërmjet një aktiviteti gjithëpërfshirës p.sh.: ekspozitë me tematikë të

caktuar, detyrë në grupe, konkurs, etj., ku secili ka një rol të caktuar në detyrën e vet. Detyra përmbledhëse, ka për qëllim të mat nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënësve. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të vlerësohen nëpërmjet një larmi mënyrash vlerësimi:

- Konkurs me njohuritë përmbledhëse të periudhës p.sh.: Shtator - dhjetor.
- Krijime individuale ose punë në grup që përfshijnë njohuritë e periudhës.
- Ekspozitë/ që përfshijnë punimet e realizuara gjatë një periudhe, ose ekspozitë me tematikë të caktuar (me qëllim përdorimin e njohurive të marra në punimet artistike).

Shënim: Në lëndën e artit pamor ky vlerësim nuk bëhet me test por me detyrë përmbledhëse. Detyra përmbledhëse synon të masë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në fund të periudhës për ndërtimin e kompetencave pamore.

MËSUESI është ai që vendos mënyrën e matjes së kompetencave pamore përmes detyrës përmbledhëse.

Analiza e rezultateve të detyrës përmbledhëse dhe puna e mësuesit për përmirësimin e rezultateve të nxënësve.

Analiza e rezultateve të detyrës përmbledhëse është një detyrë e vazhdueshme e mësuesit dhe mjaft e rëndësishme në vetëvlerësimin e performancës së tij në periudha të ndryshme, në lidhje me rezultatet e nxënësve. Kjo lloj analize bën të mundur që mësuesi të kuptojë shkaqet e rezultatit të nxënësve (në këtë rast marrim si shembull, rezultate të pakënaqshme) në detyrën përmbledhëse. Shkaqet mund të jenë të ndryshme dhe mund të kenë lidhje; *si me njohuritë dhe aftësitë e tyre të mëparshme; me humbjen e interesit të nxënësve ndaj artit pamor (kjo si rezultat i interesave ndaj artit që lidhen me moshën ose me mungesën e motivimit); përzgjedhjen e veprimtarive artistike jo në përshatje me interesat e moshës apo aftësitë personale të secilit; apo përdorimi jo në mënyrë efektive i metodave të mësimdhënies; etj..*

Një analizë e tillë do ta çojë mësuesin drejt reflektimit me kujdes ndaj çdo shkakut të mundshëm, si në mënyrë personale ndaj çdo nxënësi, ashtu edhe në rang klase. Ky reflektim do të sillte edhe zgjidhjet e duhura brenda çdo problemi specifik. *Për shembull*, nëse rezultatet e pakënaqshme kanë lidhje me humbjen e interesit të nxënësve ndaj artit pamor dhe kjo vjen si rezultat i moshës së tyre, përmendim këtu që në moshën e preadoleshencës 11- 12- 13- vjeçare, nxënësit bëhen kritikues dhe të pakënaqur ndaj cilësisë së punimeve të tyre artistike dhe pakësojnë prodhimin e

tyre artistik ose e ndërpresin atë. Në këtë rast puna dhe orientimi i duhur nga ana e mësuesit të artit është mjaft i rëndësishëm. Një nga detyrat e mësuesit është që të gjejë mënyrën për t'i udhëhequr këta nxënës drejt vetë-pranimit. Në rastet ekstreme, ai mund të tregohet i zgjuar që t'i përqendrojë më tepër në veprimtaritë e krafteve se sa te ato të vizatimit dhe të pikturës. Në këtë periudhë njohuritë mbi elementet dhe teknikat marrin përparësi dhe përzgjedhja e metodave të duhura mësimore dhe e veprimtarive artistike në përshtatje me aftësitë dhe me interesat e nxënësve, do të sillnin rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjen e rezultateve të të nxënit.

VIII.2.1 Shembull: Detyrë përmbledhëse, klasa 9-të arti pamor

Shembull i detyrës përmbledhëse: Konkurs me dy skuadra

Në përfundim të periudhës në artin pamor, një mënyrë e vlerësimit është edhe detyra përmbledhëse. Detyra përmbledhëse mund të jetë një *konkurs* i zhvilluar në klasë, mbi njohuritë e marra gjatë tremujorit. Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Pyetjet ndërtohen rreth njohurive të marra në tematikën e tretë. Për të ndërtuar një pyetësor nxënësit orientohen nga mësuesi/ja dhe libri. Mësuesi orienton nxënësit në hartimin e pyetjeve, në numrin dhe në pikëzimin e tyre.

Nxënësit kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit.

Shembuj të pyetjeve nga tematika: Historia, arti dhe shoqëria.

1. Çfarë është trashëgimia kulturore dhe pse duhet ruajtur ajo?
2. Cili është misioni i UNESCO-s?
3. Cila pjesë e trashëgimisë kulturore në Shqipëri është e regjistruar në Listën e Trashëgimisë Botërore, të mbrojtur dhe të mbështetur nga UNESCO?
4. Cilat ishin subjektet në artin bizantin?
5. Cilat janë karakteristikat e artit bizantin?
6. Cili ishte ikonografi më i njohur në shek e XVI në vendin tonë?
7. Çfarë lloj arkitekture u zhvillua në vendin tonë në periudhën e Bizantit?
8. Cilën periudhë të historisë së artit studiuuan artistët e rilindjes?
9. Cila ishte metoda shkencore që përdorën artistët e rilindjes për të paraqitur hapësirën?
10. Kush konsiderohet si artisti që përdori i pari gjuhën e rilindjes Italiane në skulpturë?
11. Përmend dy vepra të Mikelanxhelos?

12. Cilat ishin temat e preferuara të Sandro Botiçelit?
 13. Çfarë veprash ekspozon një galeri arti?
 14. Cili është misioni i një muzeu?

Klasa -----	
Tema: Konkurs me njohuritë e mara në periudhën prill-qershor	
Njohuria	Pikët
Trashëgimia kulturore	6
Arti bizantin	4
Arti bizantin në Shqipëri	4
Arti në rilindje	4
Rilindja klasike	4
Muzeu	2

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	13	14-15	16-17	18-19	20-21	22-23	23-24

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e formulimit të pyetjeve për skuadrën tjetër dhe saktësisë së përgjigjeve të pyetjeve të bëra nga skuadra tjetër. Në këtë detyrë përmbledhëse është shumë e rëndësishme mënyra sesi funksionon puna në grup dhe vlerësimi që skuadrat i bëjnë njëra tjetrës.

Shembull: plani ditor i detyrës përmbledhëse. Klasa IX

Shembull I i detyrës përmbledhëse: *Konkurs me dy skuadra* (mbi njohuritë e marra gjatë tremujorit).

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.		Situata e të nxënit: Verifikoj njohuritë mbi historinë e artit	
Tema mësimore: Konkurs me dy skuadra		Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër.	

	Nxënësit kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore <i>Nxënësi/ja:</i> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese; - përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi historinë e artit për të formuluar pyetjet; - formulon dhe u përgjigjet saktë pyetjeve në konkurs; - shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në konkurs nga skuadra. 	Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Fjalori artistik; - pyetësor; - konkurs.
Burimet/mjetet/materialet: <ul style="list-style-type: none"> - Teksti i nxënësit; - fotografi dhe ilustrime nga vepra të artit 	Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare. Lidhje me fushat kurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - teknologjia; - shkencat shoqërore. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Njohja e kulturave.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve	
Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Nxënësit kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit.	
Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja i orienton nxënësit të vendosin rregullat e konkurrimit dhe pikët e pyetjeve. Nëpërmjet një shorti ata caktojnë se cila nga skuadrat do të fillojë pyetësorin e para. Gjatë kohës së konkurrimit një nxënës/e mbledh pikët dhe kur skuadra që nuk i përgjigjet pyetjes ose i përgjigjet asaj pjesërisht, skuadra tjetër jep përgjigjen dhe argumenton pikët. Në këtë mënyrë vazhdon konkurrimi deri në përfundim të pyetësorit. Argumentimi i përgjigjeve dhe i pikëve është shumë i rëndësishëm gjatë konkurrimit.	
Hapi i tretë: Reflektimi Në përfundim të konkurrimit përzgjidhet skuadra fituese sipas numrit të pikëve të mbledhura. Nxënësit diskutojnë për mënyrën e formulimit të pyetjeve. Çdo skuadër nxjerr konkluzionet e punës në grup dhe tregon nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin. Nëse jo duhet të tregojnë se cilat ishin arsytet.	
Vlerësimi i nxënësit Ky vlerësim do të fokusohet:	

- Në diskutimet dhe bashkëpunimin për të realizuar pyetësonin;
- në cilësinë e realizimit të pyetësonit;
- në cilësinë e përgjigjeve të pyetjeve;
- në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë zhvillimit të konkursit.

VIII.2.2 Shembull II, i detyrës përmbledhëse: Ekspozitë

Detyra përmbledhëse mund të jetë një *ekspozitë* në klasë me detyrat e realizuara gjatë tremujorit. Detyra e realizimit të një ekspozite mund të jetë edhe një projekt, në rastin kur nxënësit ekspozojnë detyra me një tematikë të caktuar më parë por edhe me punime të realizuara në shtëpi për përforcimin e njohurive të marra. Në këtë rast kjo ekspozitë shërben si një detyrë përmbledhëse mbi njohuritë e mara në tematikën “Historia, arti dhe shoqëria” e cila i përket edhe tremujorit të tretë. Nxënësit vlerësohen për diskutimet mbi përzgjedhjen e punëve dhe mënyrën e ekspozimit, për mënyrën e prezantimit të punëve dhe saktësisë së prezantimit të karakteristikave të të periudhës. Në këtë detyrë përmbledhëse është shumë i rëndësishëm mënyra sesi funksionon puna në grup, pjesëmarrja e tyre aktive dhe vlerësimi që grupet i bëjnë njëra tjetrës.

Shembull I: Plani ditor i detyrës përmbledhëse: Ekspozitë

Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Historia, arti dhe shoqëria		Situata e të nxënit: Diskutime mbi mënyrën e përgatitjes së ekspozitës	
Tema mësimore: Ekspozitë		Nxënësit diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura. Mësuesi/ja i orienton nxënësit në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
<i>Nxënësi/ja:</i> <i>Zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese;</i> - <i>diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës;</i> - <i>përzgjedh punimet për ekspozim sipas periudhave artistike;</i> - <i>shpreh mendimin e tij/saj për realizimin e</i>		- Përzgjedhja e punimeve; - ekspozita; - organizimi i ekspozitës.	

<i>ekspozitës.</i>	
Burimet/mjetet/materialet: - Teksti i nxënësit; - punimet e nxënësve; - mjete të nevojshme për realizimin e ekspozitës.	Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare. Lidhje me fushat kurrikulare: - Gjuhët dhe komunikimi: letërsia; - teknologjia; - shkencat shoqërore. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - Njohja e kulturave.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve	
Hapi i parë: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve	
Nxënësit diskutojnë së bashku mbi mënyrën e ekspozimit të punëve të përzgjedhura. Mësuesi/ja i orienton nxënësit në një situatë pune të përbashkët ku bashkëpunimi është çelësi i organizimit të një ekspozite të mirë.	
Hapi i dytë: Ndërtimi i njohurive të reja	
Nxënësit ndahen në skuadra sipas periudhave artistike. Pasi kanë përcaktuar hapësirat për ekspozim dhe kanë përzgjedhur punimet e një periudhe artistike, i vendosin ato në tabakë kartoni. Në tabakët ku ndodhen punimet e realizuara duke u mbështetur në një periudhë të caktuar, nxënësit vendosin karakteristikat e periudhës dhe autorët kryesorë. Më pas i vendosin në muret e klasës. Çdo skuadër prezanton punimet e realizuara prej tyre duke u frymëzuar nga periudha përkatëse, karakteristikat dhe përfaqësuesit kryesor.	
Hapi i tretë: Reflektimi	
Ata diskutojnë mbi punimet e tyre dhe mënyrën e realizimit duke nxjerrë në pah edhe karakteristikat e periudhës. Nxënësit nxjerrin përfundimet e punës në grup duke u shprehur nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin dhe nëse ekspozita ia arriti qëllimit.	
Vlerësimi i nxënësit	
Ky vlerësim do të fokusohet:	
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në diskutimet që ata/ato bëjnë mbi përzgjedhjen e punëve dhe mënyrën e ekspozimit; ▪ në mënyrën e prezantimit të punimeve dhe periudhës artistike; ▪ në saktësinë e prezantimit të karakteristikave të periudhave artistike; ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë diskutimeve. 	

VIII.3 Vlerësimi periodik

bëhet në përfundim të çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* – NVv, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse* – NTP, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

- *Vlerësimin e portofolit lëndor – NVp*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

Nxjerrja e notës periodike: Nota përfundimtare për një periudhë në lëndën e artit pamor duhet të bëhet duke marrë parasysh vlerësimet e vazhduara, vlerësimet me teste dhe vlerësimi i detyrave të portofolit duke i nxjerrë si mesatare matematikore për secilën nga vlerësimet.

Vlerësimi përfundimtar, shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat e “Vlerësimit Vjetor” dhe në kolonën e “Notës përfundimtare”.

Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* që është rezultat i tri periudhave.

Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv. Në rast kur ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat .

Pesha në përqindje e llojeve të vlerësimit është:

- o *Vlerësimin e vazhdueshëm – 40%*
- o *Vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse – 40%*
- o *Vlerësimin e portofolit lëndor – 20%*

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_v), bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NT_p) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_p) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh.8,8 9).

Formula: $(NV_v \times 0.4) + (NT_p \times 0.4) + (NV_p \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$

Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës.

Shembull: Nxjerrja e notës përfundimtare

Periudha I			Periudha II			Periudha III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	
7	8	9	9	8	10	9	9	10	9	8	10	9

$$(9 \times 0.4) + (8 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 8.8$$

VIII.4 Regjistri i klasës

Regjistri i klasës është **dokument shtetëror**.

- Në faqet e lëndëve mësuesi vendos mungesat e nxënësit, temat e mësimit dhe realizimin e programit mësimor, të dhënat për nxënësit etj.
- Regjistri ka faqet e vlerësimit (Vlerësimi periodik dhe Vlerësimi përfundimtar), ku mësuesi vendos notat, mbasi i ka gjykuar me kujdes dhe duke u bazuar në argumente.
- Faqet e vlerësimit periodik në regjistër janë pa datë pasi **mësuesi i vendos notat, kur e shikon ai të arsyeshme dhe kur ka mbledhur një sërë informacionesh për nxënësin.**
- Mësuesi vendosnotat në **faqet e vlerësimeve në javët e fundit të periudhës**, kur e shikon ai të arsyeshme dhe jo domosdoshmërisht ditën e fundit të periudhës.
- Në përfundim të vitit shkollor nxënësi **ka 9 nota**, të cilat janë të mjaftueshme për të nxjerrë notën përfundimtare.
- Nota përfundimtare shoqërohet me **përshkrimin e niveleve të arritjes** për kompetencat lëndore.

IX. Kriteret e ndërtimit dhe të vlerësimit të portofolit

Portofoli është **koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve** të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).

Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij. Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, **përcaktojnë** detyrat dhe punimet që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.

- a) Këto detyra zhvillohen gjatë periudhës dhe nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar (në evidencë), por vetëm pjesë e portofolit lëndor.
 - b) Pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë edhe përgjatë gjithë vitit. Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.
 - c) Për vlerësimin e portofolit, mësuesi përcakton kritere të qarta dhe ua komunikon nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit varet nga pesha që secili mësues i vendos secilës detyrë.
 - d) Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet në planifikimin e periudhave si orë e veçantë ose mund të realizohet përgjatë tre - katër orëve të fundit të periudhës. Në këtë rast mësuesi përcakton një grafik të nxënësve të cilëve do t'u vlerësohet portofoli.

IX.1. Krijimi i portofolit

Në arsim, më shumë kemi të bëjmë me *kompetenca* që tregojnë “*Aftësinë e nxënësit për të demonstruar përmbushjen me sukses (brenda disa kritereve) të një detyre të caktuar, në një kontekst të dhënë*”. Portofoli i të nxënit është një qasje bashkëkohore që bazohet në kriteret e cilësisë dhe dokumenton kontributin e nxënësve në veprimtari mësimore të orientuara nga kompetenca. Portofoli është *pasqyrim i mësimdhënies të bazuar në dëshmi*;

- mësimdhënia dhe të nxënit, të vështruara nëpërmjet portofolit, ndihmon të *eksplorojmë dhe të zhvillojmë qasjet për një mësim efektiv*;
- nëpërmjet portofolit *përthyhen dhe dokumentohen qasjet e mësimin të bazuar në kompetenca/performancën e nxënësit*;
- në thelbin e tij portofoli me dokumentacionin që e përbën, *argumenton përgjegjësitë e mësuesit në lidhje me mësimdhënien dhe të nxënit*.

IX.2 Karakteristikat e portofolit të të nxënit:

- Reflekton *rezultatet e identifikuara të nxënësit* bazuar në pritshmëritë e RN të kurrikulës;

- përqendrohet në *përvojat e të nxënësve të bazuara në performancë*, si dhe në përvetësimin e kompetencave kyçe (njohurive, aftësive dhe qëndrimeve);
- përmban *shembuj të punës që shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor* dhe jo në disa ditë të shkëputura të vitit;
- përmban *produkte të punëve të nxënësve që përfaqësojnë një shumëllojshmëri* rezultatesh për t'u vlerësuar;
- përmban një *shumëllojshmëri të modeleve të punës dhe vlerësimet* e kësaj pune nga vetë nxënësit, shokët, mësuesit e tjerë, prindërit etj..

Portofoli *duhet të përmbajë disa rubrika* të cilat vendosen nga mësuesi dhe strukturohen nga mësuesi dhe nxënësi. *Rubrikat e portofolit duhet të jenë të njëjta për çdo nxënës.*

Përcaktimi i rubrikave buron nga funksioni që ka portofoli për të nxënin, si dhe procesin e vlerësimit. Pra, *vihet theksi në elemente që nuk arrijnë të vlerësohen përgjatë vlerësimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit përfundimtar.*

Sugjerohet që një portofol të përmbajë:

- Punë krijuese;
- Projekte individuale dhe në grup;
- Kërkime në internet mbi jetët dhe veprimtaritë e artistëve shqiptarë dhe të huaj;
- Koleksione të krijuara me vepra të ndryshme arti;
- Ese;
- Prezantime nga kërkime të ndryshme.

Pra, *portofoli i të nxënësve* është koleksionimi i kontributeve të nxënësit dhe paraqet përpjekjet, progresin dhe arritjet e tij në lëndën e artit pamor.

IX.3 Vlerësimi i portofolit

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve). Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra hulumtuese, krijime ose zbatime të ndryshme, projekte të nxënësve etj., që zhvillojnë *kompetencat kyçe dhe lëndore*. Detyrat e portofolit nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar të nxënësit. ***Për një periudhë detyrat që vlerësohen në portofol janë:***

☞ Projektin ose një fazë e tij, e cila është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.

☞ 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

(P.sh., në lëndët me 1-2 orë në javë portofoli mund të përmbajë një detyrë hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, ndërsa lëndët me më shumë se 2 orë, portofoli mund të përmbajë 2 detyra hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, nëse është projekt i vogël). Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënës. Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,
- aktivitete në grup ose individuale;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

Kujdes! Detyrat NUK duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.

Si dokumentohet dhe vlerësohet portofoli?

- Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Mësuesi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe iu prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë të portofolit dhe kriteret e vlerësimit të tij.
- Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos, duke u bazuar në llojin e detyrës së dhënë.
- Mësuesi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kriteret e vlerësimit duke argumentuar notën e tij.
- Instrumentet që mësuesi harton për kriteret e vlerësimit të portofolit ***nuk janë objekt monitorimi.***
- Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen.
- Vlerësimi i portofolit mund ***të planifikohet si orë e veçantë*** në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tri - katër orëve mësimore të periudhës.

- Mësuesi duhet të kujdeset që *të mos mbingarkojë nxënësin me detyra* në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të bashkërendojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të shmangur ngarkesën e nxënësve.
- Vlerësimi i portofolit *jodomosdoshmërisht* bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit.
- Në momentin që mësuesi ka përfunduar me *vlerësimin edetyrave të portofolit dhe të projektit ose të një faze të tij*, notat e portofolit i vendos në regjistër.
- Mësuesi duhet t’i udhëzojë nxënësit që t’i ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor ose t’i mbajë vetë këto detyra.

IX.3.1 Instrument i vlerëimit të portofolit të nxënësit

TREMUJORI I DYTË (__ JANAR – __ MARS 2018)

LËNDA: ARTI PAMOR

EMRI MBIEMRI : _____

KLASA: _____

NR	RUBRIKAT	VLERËSIMI		VËREJTJE
		MAX	FAKT	
1.	<i>Punë krijuese e pavarur</i>	5		
2.	<i>Projekt: Struktura të lëvizshme “Këndi i lojrave në lagjen time”</i>	10		
3.	<i>Informacion: Album me vepra të një periudhe të historisë së artit</i>	5		
		20		

KRITERE VLERËSIMI:

1. Përzgjedhja dhe përdorimi i elementeve e artit dhe mënyra e kombinimit të tyre për të realizuar idetë.
2. Përdorimi i mundësive shprehëse të teknikave artistike në mënyrë krijuese.

3. Përzgjedhja, renditja, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur të informacionit të kërkuar

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	< 7	8 - 9	10-11	12-13	13-14	15-17	18-20

X. Përshkrimi i notës përfundimtare

Shembujt më poshtë janë sugjerues. Mësuesi duhet të bëjë përshkrimin e notës sipas pikave të forta dhe të dobëta që performon nxënësi gjatë vitit shkollor mbështetur te nivelet e arritjes.

Shembull përshkrimi i vlerësimit me notë për të tria kompetencat e lëndës art pamor, klasa 6

Niveli	Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit për të tria kompetencat
Niveli 2	5 (pesë)	<i>(Nxënësi)</i> zgjedh skema të gatshme të përdorimit të elementëve të artit për të realizuar idetë artistike në krijim. Realizon punime arti dy dhe tri dimensionale me ndihmë dhe përdorimit të teknikave dhe proceseve të thjeshta artistike sipas skemave të gatshme për realizimin e punimit. Identifikon vepra arti nga disa periudha historike. Përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit.
	6 (gjashtë)	<i>(Nxënësi)</i> zgjedh skema të gatshme të përdorimit të elementëve të artit për të realizuar idetë artistike në krijim. Realizon punime arti dy dhe tri dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave dhe proceseve të thjeshta artistike duke ndjekur skema të gatshme për realizimin e punimit. Përmirëson punën duke u mbështetur kryesisht në modele të njohura dhe të gatshme. Identifikon vepra arti nga disa periudha historike. Përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit.
Niveli 3	7 (shtatë)	<i>(Nxënësi)</i> përdor elementet e artit dhe disa mënyra të kombinimit të tyre për të realizuar idetë nëpërmjet teknikave artistike në punimin e tij/saj. Realizon punë artistike dy dhe tri dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme artistike dhe mundësive shprehëse të tyre. Shpjegon veprat e artit në aspektin e tyre historik. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
	8 (tetë)	<i>(Nxënësi)</i> përdor elementet e artit dhe mënyra të ndryshme të kombinimit të tyre për të realizuar idetë krijuese nëpërmjet teknikave artistike në punimin e tij/saj. Realizon punë artistike dy dhe tri dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme artistike duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të tyre. Shpjegon veprat e artit në aspektin e tyre historik, si dhe aspektin shprehës dhe simbolik. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
	9 (nëntë)	<i>(Nxënësi)</i> përdor elementet e artit dhe mënyra të larmishme të kombinimit të tyre për të realizuar idetë në punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn, nëpërmjet teknikave të larmishme artistike. Përdor dhe eksperimenton me mundësitë e shumta shprehëse të teknikave të ndryshme artistike. Vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik si dhe aspektin shprehës. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
		<i>(Nxënësi)</i> përdor dhe përzgjedh elementet e artit dhe mënyra të larmishme të kombinimit të tyre për të realizuar idetë në punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn, nëpërmjet teknikave të larmishme

Niveli 4	10 (dhjetë)	artistike. Përdor dhe eksperimenton me mundësitë e shumta shprehëse të teknikave të ndryshme artistike. Vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik, shprehës dhe simbolik. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
-----------------	--------------------	--

Shembull përshkrimi i vlerësimit me notë për të tria kompetencat e lëndës art pamor, klasa 7

Niveli	Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit për të tria kompetencat
Niveli 2	5 (pesë)	<i>(Nxënësi)</i> përdor elementet e artit dhe teknikat artistike duke ndjekur modele të njohura për të realizuar idetë e tij/saj. Realizon punime arti dy dhe tri dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave dhe proceseve të thjeshta artistike duke ndjekur skema të gatshme për realizimin e punimit. Identifikon elemente të gjuhës vizuale në vepra arti nga periudhat e njohura historike. Përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit.
	6 (gjashtë)	<i>Nxënësi</i> përdor elementet e artit dhe teknikat artistike duke ndjekur modele të njohura për të realizuar idetë e tij/saj. Realizon punime arti dy dhe tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave dhe proceseve të thjeshta artistike duke ndjekur skema të gatshme për realizimin e punimit. Identifikon vepra arti nga periudha të njohura historike, elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë. Përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
Niveli 3	7 (shtatë)	<i>(Nxënësi)</i> përzgjedh elementet e artit dhe disa mënyra të kombinimit të tyre për të realizuar idetë nëpërmjet teknikave artistike në punimin e tij/saj. Realizon punë artistike dy dhe tri dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme artistike dhe mundësive shprehëse të tyre. Shpjegon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë dhe aspektin shprehës në një vepër arti. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
	8 (tetë)	<i>(Nxënësi)</i> përzgjedh elementet e artit dhe disa mënyra të kombinimit të tyre për të realizuar idetë nëpërmjet teknikave artistike në punimin e tij/saj. Realizon punë artistike dy dhe tri dimensionale nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme artistike duke përdorur mundësitë shprehëse të tyre. Shpjegon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë, aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër arti. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
		<i>Nxënësi</i> përdor elementet e artit dhe mënyra të larmishme të kombinimit të tyre për të realizuar idetë në punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn, nëpërmjet teknikave të larmishme artistike. Përdor dhe eksperimenton me mundësitë e shumta shprehëse të teknikave të ndryshme artistike. Vlerëson elementët e gjuhës vizuale, teknikën,

Niveli 4	9 (nëntë)	gjininë, aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër arti. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
	10 (dhjetë)	(<i>Nxënësi</i>) përzgjedh dhe përdor elementet e artit dhe mënyra të larmishme të kombinimit të tyre për të realizuar idetë në punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn, nëpërmjet teknikave të larmishme artistike. Përdor dhe eksperimenton në mënyrë të pavarur me mundësitë e shumta shprehëse të teknikave të ndryshme artistike. Vlerëson elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë, aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti duke shprehur emocionet e tij/saj. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike.

Shembull përshkrimi i vlerësimit me notë për të tria kompetencat e lëndës art pamor, klasa 8

Niveli	Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit për të tria kompetencat
Niveli 2	5 (pesë)	(<i>Nxënësi</i>) përdor elemente e artit sipas modeleve të gatshme për të realizuar idetë artistike në punimet e tij/saj. Përdor mundësitë shprehëse të teknikave tradicionale sipas modeleve të gatshme në realizimin e punimeve dy dhe tri dimensionale. Identifikon vepra arti nga periudha të ndryshme historike. Përshkruan me ndihmë elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në veprat e njohura të artit. Përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit, punën e tij/saj, punën e shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
	6 (gjashtë)	(<i>Nxënësi</i>) përdor skema të njohura idesh, kombinime të thjeshta të elementëve të artit dhe burime të njohura informacioni. Përdor efekte të thjeshta të teknikave artistike sipas modeleve të dhëna, në krijimin e punimeve dy dhe tri dimensionale. Identifikon vepra arti nga periudha të ndryshme historike. Përshkruan elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në veprat e njohura të artit. Përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit, punën e tij/saj, punën e shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
Niveli 3	7 (shtatë)	(<i>Nxënësi</i>) përdor disa ide krijuese, dhe burime të ndryshme informacioni. Përzgjedh elemente të artit për të realizuar idetë artistike në punime me tema të ndryshme. Përdor mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike në realizimin e punimeve dy dhe tri dimensionale. Përshkruan dhe analizon elementët e gjuhës vizuale, teknikën dhe gjininë në një vepër arti. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, punën e shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
		(<i>Nxënësi</i>) krijon duke përdorur disa ide krijuese dhe burime të ndryshme informacioni. Përzgjedh dhe kombinon elementët e artit për të realizuar idetë artistike në punime me tema të ndryshme. Përdor mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike në realizimin e punimeve dy dhe tri dimensionale. Përshkruan,

	8 (tetë)	analizon dhe interpreton elementët e gjuhës vizuale, teknikën dhe gjininë në një vepër arti. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, punën e shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
Niveli 4	9 (nëntë)	<i>(Nxënësi)</i> përdor ide të larmishme krijuese dhe burime të ndryshme informacioni. Përzgjedh elementët e duhur për të realizuar idetë artistike në punime me tema të personalizuar. Përdor në mënyrë të pavarur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike. Përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit, punën e tij/saj, punën e shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike.
	10 (dhjetë)	<i>Nxënësi</i> përdor ide të larmishme krijuese dhe burime të ndryshme informacioni. Përzgjedh elementët e duhur dhe përdor kombinime të shumta të tyre për të realizuar idetë artistike në punime me tema të personalizuar. Përdor në mënyrë të pavarur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike. Përshkruan, analizon, interpreton dhe vlerëson i pavarur, elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti. Përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit, punën e tij/saj, punën e shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike.

Shembull përshkrimi i vlerësimit me notë për të tria kompetencat e lëndës art pamor, klasa 9

Niveli	Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit për të tria kompetencat
Niveli 2	5 (pesë)	<i>(Nxënësi)</i> ndjek skemat e gatshme të procesit krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi. Realizon punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të thjeshta dhe modeleve të gatshme të organizimit të elementëve. Dallon aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti, në punimin e tij/saj, në punimin e shokut/shoqes. Evidenton me ndihmë rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri
	6 (gjashtë)	<i>(Nxënësi)</i> ndjek skemat e gatshme të procesit krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi dhe përmirëson punën nëpërmjet eksperimenteve të thjeshta dhe modeleve të njohura artistike. Realizon punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn dhe përshkruan hapat e teknikave artistike që ka përdorur në punimin e tij sipas modelit të dhënë. Dallon aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti, në punimin e tij/saj, në punimin e shokut/shoqes. Evidenton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneesh që lidhen me artin pamor dhe karrierën artistike.
		<i>(Nxënësi)</i> ndjek hapat e duhur të procesit krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi. Realizon punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të

Niveli 3	7 (shtatë)	ndryshme artistike dhe organizimit të elementëve. Identifikon aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti, në punën e tij/saj, në punën e shokut/shoqes. Shpjegon me ndihmë rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor dhe karrierën artistike.
	8 (tetë)	<i>(Nxënësi)</i> ndjek hapat e duhur të procesit krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi dhe përmirëson punën duke u mbështetur te eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike. Realizon punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn dhe shpjegon hapat e teknikave artistike, që ka përdorur për realizimin e punimit. Identifikon dhe shpjegon aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti, në punën e tij/saj, në punën e shokut/shoqes. Shpjegon rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor dhe karrierën artistike.
Niveli 4	9 (nëntë)	<i>(Nxënësi)</i> krijon duke përdorur në mënyrë të pavarur hapat e procesit krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike. Realizon në mënyrë të pavarur punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike dhe organizimit të elementëve. Identifikon dhe vlerëson aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti, në punën e tij/saj, në punën e shokut/shoqes. Vlerëson rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor dhe karrierën artistike.
	10 (dhjetë)	<i>(Nxënësi)</i> krijon duke përdorur në mënyrë të pavarur hapat e procesit krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike. Realizon në mënyrë të pavarur punë dy dhe tri dimensionale në art dhe dizajn dhe shpjegon hapat e teknikave artistike dhe mundësitë e tyre shprehëse që ka përdorur për realizimin e punimit. Identifikon dhe vlerëson në mënyrë të pavarur aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti, në punën e tij/saj, në punën e shokut/shoqes. Vlerëson i pavarur rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor dhe karrierën artistike.